



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 238 AKTI

NR. 184 VENDIMI

Tiranë, më 19.7.2019

VENDIM

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	kryesues
Alma Faskaj	relatore
Suela Zhegu	anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 19.7.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla 1, me adresë: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anila Guri**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim Kushtetuta);

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri, ushtron detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* me përparësi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), duke qenë kandidate për në Gjykatën Kushtetuese.

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 18.1.2019, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisioner Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

4. Në datën 6.2.2019 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, në datën 7.2.2019 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 28.6.2019 Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Anila Guri, për të tri kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 1.7.2019 subjektit iu njoftuan rezultatet e hetimit dhe, po në këtë datë, konfirmoi në rrugë elektronike njohjen me rezultatet e hetimit kryesisht për rivlerësimin e tij.

7. Në datën 12.7.2019 subjekti i rivlerësimit konfirmoi me anë të *e-mail*-it, por edhe në rrugë zyrtare, dërgimin e prapësimeve dhe dokumentacionin referues nr. (***) prot., datë 11.7.2019.

8. Në datën 15.7.2019 trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Anila Guri, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 17.7.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Në datën 17.7.2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj Anila Guri, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj Anila Guri. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 17.7.2019, për të rifilluar në datën 19.7.2019 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Anila Guri ka qenë përgjithësisht bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni vëren se gjithashtu është konstatuar mungesë në dhënien e informacionit të kërkuar, duke vënë në vështirësi Komisionin gjatë procesit të rivlerësimit të saj lidhur me kriterin e pasurisë.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Por, referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit dërguar Komisionit; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. (***) prot., datë 6.7.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës “Vetting”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri.

Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

Procesi i rivlerësimit nga Komisioni për komponentin e pasurisë është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë nga

viti 2003 e në vijim nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

Subjekti i rivlerësimit, znj, Anila Guri, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “Vetting” në datën 30.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Në “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

1. Banesë e ndodhur në ish-rrugën “(*)”, sot rruga “(***)”, Tiranë**

Kjo pasuri është ndërtuar në truallin në pronësi të personit të lidhur, bashkëshortit, z. D. G., e përbërë nga tri kate dhe një kat bodrum, me sip. banimi rreth 460 m², filluar së ndërtuari në vitin 1998, aktualisht në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t, Tirana Jug¹. Burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë është ndërtuar me të ardhurat e bashkëshortit të fituara nga aktiviteti i tij tregtar pas vitit 1990 dhe puna pranë disa institucioneve. Në pjesën e mobilimit ka kontribuar edhe subjekti.

Vlera e pasurisë: 6.500.000 lekë, së bashku me mobilimin.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

Faktet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara

- Pasuria është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2003. Në këtë akt subjekti ka deklaruar: truall me sip. 1000 m², në vlerën 3.000.000 lekë dhe banesë 2 kate + papafingo, e ndodhur në Rr. “(***)” Tiranë, në vlerën 7.000.000 lekë. Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, subjekti, në DPV-në e vitit 2003 ka përkthyer: *trashëgimi dhe kursime të bashkëshortit, të ardhura nga shitja e një banese në Gjirokastrë, si dhe të ardhura familjare.*

Për këtë pasuri Komisioni zhvilloi hetime autonome si vijon:

Lidhur me saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”

Për truallin ku është ndërtuar banesa

Subjekti ka deklaruar dhe i ka bashkëlidhur deklaratimit kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. (***) , datë 13.11.1998, për truall me sip. 1500 m² – dy parcela. Subjekti shpjegon se ndërtimi është bërë pikërisht në këtë sipërfaqe toke, përkatësisht atë me sip. 1.000 m², pasi sip. 500 m² është shitur nga bashkëshorti i subjektit.

Nga hetimi i Komisionit², nga ZVRPP-ja Tiranë fillimisht nuk u konfirmua asnjë pasuri e llojit “tokë” apo “truall” në emër të subjektit apo të personit të lidhur, bashkëshortit të saj, z. D. G. . Në

¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës “Vetting”: kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. (***) , datë 13.11.1998, blerës D. G., për truall me sip. 1500 m², në dy parcela të pasqyruara në planvendosjen e kësaj prone objekt shitjeje (500+1000 m²), ndodhur në Tiranë, në shumën 1.500.000 lekë; vërtetim hipotekor nr. (***) , datë 16.11.1993, pasuri e llojit truall me sip. 1.500 m² në dy parcela, në pronësi të z. D.G. + kartelë pasurie; vërtetim nr. (***) , datë 13.1.2017 nga ALUIZNI, Tirana Jug, ku rezulton se z. D. G. është vetëdeklarues për proces legalizimi të një objekti informal, bashkëlidhur vërtetimi datë 7.11.2006, për objekt i ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, ndërtuar në vitin 1998, me sip. ndërtimi 170 m², 3 kate + 1 nën tokë + certifikatë familjare + fotografi e banesës + miratim lidhje në TM, 12.9.2000.

² Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. ZVRPP-ja Tiranë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***)prot., datë 3.2.2019.

vijim, ky institucion informon se kjo tokë ka qenë e regjistruar në emër të personit të lidhur, D. G., por prona nuk është në sistem.

ALUIZNI, Tirana Jug, me shkresën nr. (***) prot., datë 7.11.2006, konfirmon se personi i lidhur ka depozituar formularin e vetëdeklarimit, në të cilin ka pasqyruar të dhënat e ndërtimit pa leje, dhe konkretisht, *sipërfaqe e zënë: 850 m²; sipërfaqe ndërtimi (në bazë): 170 m²; numër katesh: 3 kate mbi tokë + 1 kat nëntokë; viti i ndërtimit: viti 1998*. Ndërkohë, me VKM-në nr. 805, datë 22.7.2009, “Për kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale...” në numrin rendor 164 të listës emërore të kalimit të pronësisë për Njësinë Bashkiake nr. 2 Tiranë, figuron emri i shtetasit D. L. G. (bashkëshorti), pasuria nr. (***), z.k. (***), për përfitimin e truallit me sip. 507 m².

Pra, për sa më sipër, rezultoi se me VKM ishte vendosur kalimi i sipërfaqes ndërtimore, pikërisht asaj sipërfaqeje për të cilën subjekti ka deklaruar se e kishte blerë me kontratë shitjeje nga ish-pronarët T. .

Duke qenë se rezultonte e paqartë sipërfaqja e zënë me ndërtim, si dhe nëse ndërtimi është bërë nga subjekti në tokën e tij apo jo (edhe pse kemi një referim të ndryshëm të sipërfaqeve të zëna me ndërtim), Komisioni kërkoi sqarime nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti, ndër të tjera, sqaroi: *“Nuk më kujtohet se nën ç’rrethana në formularin e vetëdeklarimit është shënuar se sipërfaqja e truallit prej 850 m². Ndoshta një deklaram i tillë është bërë duke vlerësuar së në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, duhej të deklarohesh sipërfaqja e domosdoshme funksionale e banesës. Në pronësi të bashkëshortit tim që nga koha e shitjes së sipërfaqes prej 500 m², ka mbetur sipërfaqja e truallit prej 1000 m². Nuk kam deklaruar asnjëherë ndonjë ndryshim nga pikëpamja juridike lidhur me sipërfaqen e truallit në pronësi të tij, pasi asnjëherë nuk ka pasur një të tillë”*.

Subjekti ka shoqëruar përgjigjen me dokumentacionin nga ZVRPP-ja Tiranë, nga i cili sipërfaqja e tokës prej 1000 m² është tashmë e regjistruar në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

Për çmimin e deklaruar të truallit

Në DPV-në e vitit 2003 subjekti ka deklaruar vlerën 3.000.000 lekë, ndërkohë, në deklaratën “Vetting” subjekti ka paraqitur të dhënat në kontratën e shitjes dhe sqaron: *“Lidhur me vlerën e truallit, vlera e tij është ajo që është shënuar në kontratën e blerjes të datës 13.11.1998, me nr. (***)”*.

Për sa më sipër, Komisioni çmon se banesa e deklaruar është ndërtuar në truallin e blerë dhe të regjistruar në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. D. G. . Komisioni çmon se ka një deklaram të saktë lidhur me aktin juridik në bazë të të cilit është ndërtuar kjo banesë, por ka deklarim të pasaktë lidhur me vlerën e truallit mbi të cilin është ndërtuar banesa.

Për sipërfaqen e banesës

Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se deklarimi i bërë nga subjekti për sipërfaqen e ndërtimit në DPV-në e vitit 2003 (banesë 2 kate + papafingo), është i pasaktë.

Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t. Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 4.2.2019.
ALUIZNI, Tirana Jug, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 19.2.2019.

Nga hetimi konstatohet deklaram i pasaktë i sipërfaqes së ndërtimit në DPV-në e vitit 2003, duke mos deklaruar një kat, i cili, pas shpjegimeve të subjektit, ka rezultuar bodrum.

Subjekti, i pyetur lidhur me këtë fakt, deklaroi: *“Unë kam deklaruar sipërfaqen e banesës prej 460 m², ndërtesë me 3 kate + një kat bodrum... Deklaroj se që nga koha e ndërtimit të banesës nuk është bërë asnjë ndryshim lidhur me masën e sipërfaqes ndërtimore dhe numrin e saj të kateve. Që me fillimin e ndërtimit të saj ajo ka qenë konceptuar një banesë, ndërtesë me 3 kate (2 kate dhe papafingo) + një kat bodrum, dhe ashtu është dhe sot.”*

Komisioni çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me sipërfaqen e ndërtesës ka qenë i pasaktë në DPV-në e vitit 2003.

Për vlerën e ndërtimit

Në DPV-në e vitit 2003 subjekti deklaroi si vlerë të kësaj banese 7.000.000 lekë, ndërsa në deklaratën “Vetting” deklaroi vlerë 6.500.000 lekë, së bashku me mobilimin – pra, edhe pse shtohet një kat në deklaram dhe mobilohet, vlera e pasurisë zbrit në total me të paktën 500.000 lekë.

Nga hetimi ka rezultuar se vlera 7.000.000 lekë është vlera që subjekti ka deklaruar dhe në ILDKPKI në vitin 2013³ gjatë procedurës së kontrollit të ushtruar nga ky organ.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Gjatë hetimit administrativ subjekti sqaroi: *“Ndërsa lidhur me deklarimin e vlerës së banesës, unë e kam bërë një deklaram të tillë pa pasur një informacion të saktë lidhur me vlerën reale të shpenzuar për ndërtimin e saj. Ajo është ndërtuar nga bashkëshorti im dhe ai asnjëherë nuk ka disponuar një kontratë sipërmarrje apo porosie të lidhur me shkrim...”*

Subjekti ka bashkëngjitur një aktekspertim lidhur me vlerën e këtij ndërtimi dhe sqaron: *“Eksperti, bazuar në kohën e ndërtimit, ka sqaruar se çmimi mesatar për njësi për një m² ishte në masën 12.883 lekë/m². Eksperti është bazuar në të dhënat e pasqyruara në vendimin me nr. 815 datë 9.12.1996, ‘Për miratimin e vleftave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vleftës së koeficientit ‘K’, akt i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27 extra, datë 3.3.2008. Eksperti ka përcaktuar se vlera totale e koston së ndërtimit të banesës është afërsisht 5.400.000 lekë.”*

Subjekti, lidhur me aktet nënligjore për përcaktimin e vlerës së ndërtimit, sqaron si më poshtë vijon: *“Unë kam deklaruar në mënyrë të vazhdueshme se banesa është ndërtuar në vitin 1998. Ky vit është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, në deklarimin fillestar të bërë për vitin 2003, si dhe në deklaratën ‘Vetting’. Ajo mund të mos ketë përfunduar në vitin 1998, por nuk mund të pretendohet se ka filluar të ndërtohet në vitin 2000, pasi një vlerësim i tillë vjen në kundërshtim me të gjitha aktet e depozituara lidhur me këtë fakt.*

Nëse do të merrnim për bazë koston e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për Tiranën, për vitin 1995, bazuar në VKM-në nr. 815, datë 9.12.1996, akti ky që ka rregulluar situatën deri në vitin 1998, vlera e sipërfaqes ndërtimore për 1 m², përcaktuar sipas këtij akti është 12.883 lekë/m² (dhe jo vlera prej 24.780 lekësh/m²)”.

Komisioni, në vlerësim të provave të administruara gjatë hetimit, si dhe të akteve ligjore e nënligjore që përcaktojnë koston e ndërtimit, çmoi se për të përcaktuar vlerën e përafërt të ndërtimit duhen marrë për bazë aktet nënligjore që përcaktojnë koston e ndërtimit në vitin 2000. Sipas dokumentit kontratë të sjellë nga subjekti, personi i lidhur ka blerë truallin me sip. 1.500 m² në nëntor të vitit 1998. Konkretisht, kostoja e ndërtimit në vitin 2000 i referohet VKM-së nr. 362, datë 14.7.2000,

³ Shkresa nr. (***)prot., datë 26.4.2019.

“Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit ‘K’, ku në pikën 1 përcaktohet: “1. Kostoja mesatare, në shkallë republike, e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2000 është 24.780 lekë/m²”. Për rrjedhojë, vlera referuese më e përafërt e ndërtimit të banesës me sip. 460 m² (deklaruar në deklaratën “Vetting”) do të ishte 11.398.800 lekë.

Komisioni çmon se bazuar në parimet e zbatimit në kohë të normës juridike (*ratio tempore*) dhe në aktin e cituar prej subjektit, pasi VKM-ja nr. 815, datë 9.12.1996 (për vetë natyrën orientuese që ka) përcakton referenca të kostos së ndërtimit vetëm për vitin 1995 (*ex tunc*) dhe institucioni që e ka nxjerrë aktin nuk ka përcaktuar mbi vazhdimin e referencave nga data e publikimit deri në momentin e përditësimit apo ndryshimit të tyre (*ex nunc*). Ndërkohë që është pikërisht VKM-ja nr. 362, datë 14.7.2000, që parashikon kostot e viteve pararendëse.

Për sa më sipër, Komisioni çmon se lidhur me vlerën e shtëpisë subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DPV-në e vitit 2003 dhe në deklaratën “Vetting”.

Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga subjekti dhe personi i lidhur

Subjekti, në DPV-në e vitit 2003, deklaroi: *“...të ardhura nga shitja e një banese në Gjirokastër dhe të ardhura familjare”*, ndërsa në deklaratën “Vetting” deklaroi: *“...me të ardhurat e bashkëshortit të fituara nga aktiviteti i tij tregtar pas vitit 1990 dhe puna pranë disa institucioneve...”* Në deklaratën “Vetting” hiqet burimi nga “shitja e një banese në Gjirokastër”, si dhe “kursime”.

Rezulton se në të dyja deklaratat e sipërcituara subjekti ka deklaruar pjesën takuese të 50 % të pasurisë së bashku me bashkëshortin, personin e lidhur.

Në analizë të burimit të ligjshëm të kësaj pasurie, fillimisht Komisioni çmoi me rëndësi të mbante një qëndrim lidhur me këto çështje:

1. *Pasuria do të konsiderohet një pasuri në bashkëpronësi me personin e lidhur dhe për pasojë do të analizojë burimin e ligjshëm për krijimin e saj, bazuar në të ardhurat, si nga ana e personit të lidhur dhe të subjektit.*

2. *A mund të konsiderohet kjo pasuri një pasuri e vënë jashtë periudhës së rivlerësimit para se subjekti të lidhë martesë me personin e lidhur?*

Lidhur me faktin nëse pasuria do të konsiderohet një pasuri në bashkëpronësi me personin e lidhur subjekti sqaron: *“Përtej çdo shpjegimi që unë kam dhënë në mënyrë të shprehur, kur më është dashur të plotësoj rubrikën e shënuar ‘pjesa që zotëron subjekti’, kam shënuar ‘zotërimi 50 % me bashkëshortin’”*.

Ky është një deklaram i pasaktë, i bërë pa treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur dhe e ndikuar vetëm nga parimi i prezumimit ligjor të bashkëpronësisë së barabartë midis bashkëshortëve.

“Pra, unë kam deklaruar për herë të parë pjesën takuese në 50 %, duke menduar sesa moralisht më takon të kem një ditë nga ajo pasuri (juridikisht inekzistente) dhe jo nisur nga vlera reale e kontributit për ngritjen e saj.

Vlerësoj se ky deklaram shifror nuk mund të prevalojë dhe as të bëjë nul të gjitha deklaramet e tjera që kam bërë në vazhdimësi mbi krijuesin e kësaj pasurie, që ka qenë bashkëshorti im”.

Lidhur me sa më lart, Komisioni i referohet një qëndrimi që Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur në vendimin nr. 6 datë, 28.2.2019, kur shprehet: *Në kuptim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, çdo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e ligjit të rivlerësimit, që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë “Vetting”, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Në referim të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstatohet se në asnjë prej dispozitave të këtij korpusi ligjor nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kritere vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe personave të lidhur, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016.*

Në rastin, objekti gjykimi, vlen të evidentohet se rezulton e provuar se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit ka filluar të banojë në këtë banesë pasi është martuar me personin e lidhur në vitin 2000, i cili e ka ndërtuar para se të fillojë bashkëjetesën me subjektin.
- ✓ Deklarimi i pjesës 50 % rezulton të jetë qartësisht një deklarim i pasaktë, i bërë nga subjekti, duke marrë në konsideratë faktin se konsiderohet si pasuri bashkëshortore, në bazë të nenit 74 të Kodit të Familjes, dhe jo një pasuri e cila duhet të konsiderohet e përbashkët në kuptim të kontributit të dhënë nga të dy subjektet.
- ✓ Nuk rezultoi e provuar se subjekti ka kontribuar në ndërtimin e saj para momentit të lidhjes së martesës.
- ✓ Duke qenë se kjo banesë ende nuk është e regjistruar nuk ka një akt juridik që të përcaktojë pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit, me qëllim analizën e tyre.

Për sa më sipër, Komisioni çmon se duke qenë se kjo pasuri është një pasuri që është vendosur nga personi i lidhur para se të lidhë martesë me subjektin e rivlerësimit, duhet të vlerësohet rast pas rasti niveli i verifikimit të burimeve, nëse burimi i ligjshëm duhet t’i nënshtrohet kërkesave të nenit D të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe të analizohet në mënyrë logjike dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit çdo lloj pasoje e mundshme që mund të transferohet te subjekti, për sa kohë ekspozimi i saj ndaj çdo parregullsie formale apo administrative të tjetërkujt, duhet të kufizohet brenda kornizave ligjore detyruese.

Gjithsesi, nisur nga fakti që kjo pasuri është përdorur për një periudhë të gjatë dhe vijon të përdoret nga subjekti i rivlerësimit dhe nga familja e saj, se posedimi aktual, edhe pse ende nuk është formalizuar, përkon *de facto* me pronësinë bashkëshortore të subjektit, gjë që do të gjejë zyrarizmin e të drejtës së pronësisë në momentin e regjistrimit. Komisioni çmon se për sa më lart është i legjitimuar që të kryejë hetime lidhur me mundësinë e personit të lidhur për të realizuar ndërtimin/krijimin e kësaj pasurie.

Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. D. G., ka deklaruar si më poshtë vijon:

- ✓ *Të ardhura të përfituara nga aktiviteti tregtar me kambizëm në qytetet e Shkodrës, Durrësit dhe Tiranës, për periudhën 1990 – 1992; nga aktiviteti tregtar bar-kafe (disko) pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, objekt i marrë me qira; shitje automjetesh të përdorura në periudhën 1990 – 2000 . Shuma: rreth 10.000.000 lekë.*
- ✓ *Të ardhura nga shitja e truallit me sip. 500 m², i ndodhur në ish-rrugën “(***)”, sot rruga “(***)” me kontratën nr. (***), datë 17.11.1998, para noterës E. T., Tiranë. Shuma: 1.500.000 lekë.*

- ✓ *Të ardhura nga puna pranë Drejtorisë së Policisë Shkodër nga shtatori i vitit 1994 – mars të vitit 1995. Jam interesuar pranë drejtorisë së Policisë Shkodër dhe nuk më është dhënë asnjë informacion me pretendimin se dokumentet e asaj kohe nuk ekzistojnë, pasi janë dëmtuar (djegur) gjatë trazirave të vitit 1997.*
- ✓ *Të ardhura nga puna pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën nga prilli i vitit 1995 – mars të vitit 1999. Shuma: 576.772 lekë. Gjatë kësaj periudhe kam përfituar nga paga rreth 170.000 lekë, pasi kam punuar në vijimësi pranë këtij institucioni, por gabimisht nuk janë pasqyruar në vërtetimin e lëshuar nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- ✓ *Të ardhura nga puna e bashkëshortit pranë Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Krujë, nga korriku i vitit 2002 — prill të vitit 2004. Shuma: 585.641 lekë.*

Në dokumentacionin justifikues, përveç vërtetimeve mbi të ardhurat e subjektit, të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti ka bashkëlidhur me deklarinimin edhe kërkesa të drejtuara institucioneve për konfirmimin e të ardhurave të bashkëshortit⁴.

Komisioni kreu verifikimet mbi gjendjen financiare dhe aktivitetet e mundshme tregtare nëpërmjet korrespondencës me institucionet përkatëse⁵.

Nga të dhënat e siguruar, pas administrimit të përgjigjeve të ardhura, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj, nuk kanë ushtruar asnjë aktivitet tregtar në periudhën e ndërtimit të shtëpisë dhe as kanë zotëruar aksione apo kuota në ndonjë subjekt tregtar sh.a., apo sh.p.k.

Në analizë të dokumentacionit bashkëngjitur deklaratës “Vetting” dhe ato të administruara gjatë hetimit administrativ, konstatohet se totali i të ardhurave të ligjshme të personit të lidhur, deri në fund të viti 2002 rezulton të jetë në shumën 801.614 lekë⁶.

Pas analizës së burimit të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie, në vlerësim të dokumentacionit të personit të lidhur, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur burim të ligjshëm të mjaftueshëm për krijimin e likuiditeteve për ndërtimin e kësaj banese.

Analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe personit të lidhur dhe mjaftueshmëria financiare janë të përshkruara në tabelën më poshtë.

Analiza financiare deri në vitin 2002 për personin e lidhur, bashkëshortin e subjektit	Para vitit 2003
Pasuri	12,898,800
Tokë truall me sip. 1000 m ² , Rr. “(***)”, Tiranë	1,500,000

⁴ Subjekti ka vënë në dispozicion: kërkesë drejtuar Ministrisë së Brendshme (pa datë), ku i kërkohet konfirmimi i marrëdhënieve të punës për periudhën 1994 – 1995; të ardhurat e realizuara nga puna si Officer i Policisë Gjyqësore; si dhe vërtetim për pagën neto, pa datë, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pagën neto të viteve 1995 – 1999.

⁵ - Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare.

- Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore; AQSSH-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 8.2.2019 (KPK 535).

- Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit; QKB-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 14.2.2019 (KPK 537).

- Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; DPT-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 31.1.2019 (KPK 538). DRT-ja Shkodër ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 6.2.2019 (KPK 538).

⁶ Pas dërgimit të prapësimeve, Komisioni i shtoi të ardhurave të bashkëshortit shumën prej 70.000 lekësh për vitin 1997, pasi subjekti pretendoi se është djegur arkiva dhe ky pretendim u mor në konsideratë dhe shuma e të ardhurave deri në fund të vitit 2002 është 801.614 lekë.

Banesë 2 kate + papafingo	11,398,800 ⁷
Të ardhura të dokumentuara	3,085,894
Të ardhura nga punësimi, bashkëshorti	801,614
Të ardhura nga shitja e apartamentit të prindërve të përfituara nga privatizimi ⁸	360,000
Të ardhura nga dëmshpërblimi, bashkëshorti ⁹	424,280
Të ardhura nga shitja e truallit ¹⁰	1,500,000
Shpenzime	827,282
Shpenzime jetese ¹¹	827,282
Të ardhura – Shpenzime – Pasuri	- 10,640,188

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe nga provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se lidhur me këtë pasuri:

- Subjekti ka deklaruar saktë lidhur me aktin juridik të fitimit të truallit në Rr. “(***)”, në të cilin është ndërtuar banesa e familjes së saj.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me pjesën që zotëron në këtë banesë.
- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me sipërfaqen e ndërtimit dhe vlerën e objektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.
- Subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit se personi i lidhur ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave të përdorura për ndërtimin e banesës në Rr. “(***)”, në shumën 10.640.188 lekë.

Lidhur me konkluzionin e fundit dhe në përmbyllje të analizës së kësaj pasurie, Komisioni e gjen me vend të specifikojë faktin që, edhe sikur të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me referencën e koston së ndërtimit të objektit në fjalë – duke e konsideruar (koston e ndërtimit) në shumën prej 5.400.000 lekësh, aq sa eksperti i zgjedhur nga vetë subjekti e ka përcaktuar – gjithsesi do të konstatohej një mungesë e burimeve financiare të ligjshme prej rreth 4.640.000 lekësh, për krijimin e kësaj pasurie.

2. Autoveturë tip “Golf Volkswagen”, viti i prodhimit 2000, blerë në datën 19.3.2010

Kjo pasuri është përfituar me kontratën nr. (***), datë 19.3.2010, në vlerën 500.000 lekë, me burim krijimi të deklaruar nga të ardhurat e krijuara nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

⁷ Sipas koston së ndërtimit të vitit 2000, e cila është referenca me koston më e ulët të ndërtimit, që përfshin vitet pararendëse, në krahasim me referencat e tjera alternative, sipas të cilave kostoja e godinës në fjalë do të ishte shumë më e lartë.

⁸ Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti ngriti pretendimin se bashkëshorti i saj ka përfituar pjesën takuese të të ardhurave nga shitja e shtëpisë së përfituar nga privatizimi në shumën 360.000 lekë, shumë e cila u përfshi në analizën financiare.

⁹ Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit pretendoi se shuma e marrë nga ky aksident ka qenë 20.000 DEM + 50.000 lekë të ardhura nga shitja e këtij automjeti, referuar dhe deklaratës noteriale të kohës dhe kontratës së lidhur për shitjen e atij automjeti të kohës. Trupi gjykues çmoi se duhet të merret në konsideratë ky pretendim, por nga kjo shumë duhet të zbritet shuma prej 14.000 DEM (e deklaruar prej subjektit se në momentin e blerjes kjo makinë ka kushtuar 14.000 - 15.000 DEM) dhe në total shuma e të ardhurave neto të përfituara nga ky aksident është = 20.000 DEM + 50.000 ALL – 14.000 DEM = 424.280 lekë.

¹⁰ Shihni kontratën e shitjes së truallit nr. (***), datë 17.11.1998.

¹¹ Shpenzimet e jetesës nga viti 1995 deri në vitin 1997 janë llogaritur si 80 % e të ardhurave nga paga për subjektin, ndërkohë që për periudhën 1998 – 1999 janë llogaritur shpenzime jetese në vlerën 5.000 lekë/muaj për bashkëshortin e subjektit, kurse për periudhën 2000 – 2002 janë llogaritur shpenzime jetese për familjen prej 3 anëtarësh sipas ILDKPKI-së.

Kjo pasuri deklarohet për herë të parë në deklaratën e pasurive të vitit 2010. Nisur nga deklarimi dhe dokumentacioni justifikues i vënë në dispozicion nga subjekti (në veçanti nga kontrata e shitblerjes nr. (***) , datë 19.3.2010, për automjetin me targa (***) , Komisioni kreu verifikimet nëpërmjet korrespondencës me DPSHTRR-në¹², e cila konfirmon pronësinë e subjektit mbi automjetin e blerë¹³. Subjekti deklaroi në kontratë se e ka likuiduar shumën 500.000 lekë *cash* jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës.

Për sa më sipër, rezulton deklarim i saktë lidhur me këtë pasuri si në DPV-në e vitit 2010, ashtu dhe në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

Lidhur me verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie, nga njësia ligjore është kryer një analizë financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe të bashkëshortit të saj nga puna për vitin 2010, nga data 1.1.2010 deri në ditën e blerjes së makinës 19.3.2010, të dhënat dhe rezultatet e të cilës janë të përshkruara në tabelën më poshtë:

Analiza financiare sipas burimit të deklaruar	Periudha 1.1.2010 – 19.3.2010
Pasuri	500,000
Automjet “Golf Volkswagen”, i blerë në vitin 2010	500,000
Të ardhura	459,393
Të ardhura nga punësimi, subjekti, periudha 1.1.2010 – 19.3.2010	267,393
Të ardhura nga punësimi, bashkëshorti, periudha 1.1.2010 – 19.3.2010 ¹⁴	192,000
Shpenzime	111,902
Shpenzime jetese ¹⁵ , periudha 1.1.2010 – 19.3.2010	91,080
Shpenzime udhëtimi ¹⁶ , periudha 1.1.2010 – 19.3.2010	20,822
Të ardhura – Shpenzime – Pasuri	- 152,509

Në lidhje me sa më sipër, në prapësimet ndaj rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se:

“Për periudhën nga 1.1.2010 – 31.12.2010 bashkëshorti im pranohet se ka realizuar të ardhura nga vetëpunësimi në masën 1.152.000 lekë. Të ardhurat nga aktiviteti i tij nuk mund të llogariten mbi një tarifë fikse të përmuajshme, sepse aktiviteti i tij është sipërmarrje private dhe të ardhurat varen nga sasia dhe cilësia e shërbimit të shitur, e cila nuk mund të jetë e njëtrajtshme për të gjithë vitin, por varet nga kërkesa dhe oferta në treg. Gjithashtu, në atë kohë mund të këtë pasur rast që është parapaguar pjesërisht dhe fatura tatimore është lëshuar në përfundimin e plotë të ofrimit të shërbimit. Për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet se ka pasur pamjaftueshmëri financiare për krijimin e kësaj pasurie”.

Lidhur me pretendimin e realizimit të të ardhurave nga vetëpunësimi i bashkëshortit në shumën 1.152.000 lekë, Komisioni çmon se ato kanë mbetur në nivel deklarativ, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova bindëse për sa ka pretenduar.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

¹² Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor; DPSHTRR-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 25.1.2019.

¹³ Në bazë të kontratës nr. (***) , datë 19.3.2010, automjeti është pajisur me targën (***) .

¹⁴ Në përcaktimin e vlerës së të ardhurave të personit të lidhur është bërë një ndarje në mënyrë të barabartë të fitimit në çdo muaj të vitit.

¹⁵ Shpenzimet e jetesën nga ILDKPKI-ja, e cila bazohet në INSTAT.

¹⁶ Shpenzimet e udhëtimeve të rezultuara nga sistemi TIMS.

Sipas burimit të deklaruar për periudhën 1.1.2016 – 20.5.2016	2016
Pasuri	946,890
Automjet tip “Mercedes Benz”, i blerë në vitin 2016, në vlerën 7.000 euro ²⁰	946,890
Të ardhura	1,265,559
Të ardhura nga punësimi, subjekti, periudha 1.1.2016 – 20.5.2016	566,087
Të ardhura nga punësimi, bashkëshorti, periudha 1.1.2016 – 20.5.2016	699,472
Shpenzime	510,858
Shpenzime jetese ²¹ , periudha 1.1.2016 – 20.5.2016	391,820
Shpenzime udhëtimi ²² , periudha 1.1.2016 – 20.5.2016	119,038
Të ardhura – Shpenzime – Pasuri	- 192,189

→ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë lidhur me pasurinë e luajtshme.

→ Rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë burime të ligjshme financiare, të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010, pasi nuk justifikon me burime të ligjshme të të ardhurave për blerjen e automjetit, shumën 152.509 lekë.

3. Autoveturë tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 2006

Kjo pasuri është blerë në datën 20.5.2016, në vlerën 7.000 euro, me burimi krijimi: të ardhurat e krijuara nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.¹⁷

3.1 Faktet nga hetimi administrativ kryesisht

Pasuria deklarohet për herë të parë në deklaratën e pasurive të vitit 2016. Rezulton se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë si në DPV-në e vitit 2016, ashtu dhe në deklaratën “Vetting”. Nisur nga deklarimi dhe dokumentacioni justifikues i vënë në dispozicion nga subjekti, Komisioni kreu verifikimet nëpërmjet korrespondencës me DPSHTRR-në¹⁸, e cila konfirmon pronësinë e subjektit mbi automjetin me targa (***)¹⁹. Subjekti deklaroi në kontratë se e ka likuiduar shumën 7.000 euro *cash* jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës. Rezulton se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e DPSHTRR-së dhe me kontratën e shitblerjes.

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi (për pasurinë automjet të blerë në vitin 2016) të ardhurat e krijuara nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Prandaj, për të analizuar blerjen e këtij automjeti Komisioni i është referuar të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe të bashkëshortit nga puna për vitin 2016, nga data 1.1.2016 deri në ditën e blerjes së automjetit (20.5.2016).

Në vijim, nga njësia ligjore është kryer analiza financiare për krijimin e kësaj pasurie:

¹⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratë shitblerjeje automjeti nr. (***) , datë 20.5.2016, me blerës D. G., të automjetit tip “Mercedes Benz”, në vlerën 7.000 euro.

¹⁸ Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor; DPSHTRR-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 25.1.2019 (në veçanti nga kontrata e shitblerjes nr. (***) , datë 20.5.2016 për automjetin me targa (***)).

¹⁹ E blerë në bazë të kontratës nr. (***) , datë 20.5.2016.

²⁰ Sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) datë 20.5.2016, konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2016.

²¹ Shpenzimet e jetesës nga ILDKPKI-ja, e cila bazohet në INSTAT.

²² Shpenzimet e udhëtimeve të rezultuara nga sistemi TIMS.

Sipas analizës financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2016, siç përshkruhet në tabelën e mësipërme.

Në lidhje me sa më sipër, në prapësimet ndaj rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar: *“Lidhur me përcaktimin e masës së të ardhurave të bashkëshortit deri në datën 20.5.2016 në masën prej 699.472 lekësh, nuk jepet ndonjë analizë financiare apo shpjegim se pse është llogaritur në këtë vlerë.*

Nëse është përdorur metoda e përdorur, si dhe për pasurinë automjet tip ‘Golf Volkswagen’ kam të njëjtin argument.

Për periudhën nga data 1.1.2016 – 31.12.2016 bashkëshorti im pranohet se ka realizuar të ardhura nga vetëpunësimi në masën 1.678.732 lekë”.

Gjithashtu, subjekti pretendoi se si burim për blerjen e këtij automjeti ka shërbyer shitja e automjetit tip “Land Rover” në vitin 2016. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se automjeti tip “Land Rover” është shitur²³ në datën 14.9.2016, ndërsa automjeti tip “Mercedes Benz” është blerë në datën 20.5.2016. Nga sa më sipër, rezulton se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Land Rover” nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedez Benz”.

Në seancë dëgjimore subjekti u shpreh lidhur me blerjen e këtij automjeti, duke deklaruar se një pjesë e parave janë parapaguar, kurse pjesa tjetër është dhënë në momentin e lidhjes së kontratës. Në lidhje me këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit nuk referoi dhe nuk paraqiti në Komision asnjë provë shkresore në mbështetje të pretendimeve të saj.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë lidhur pasurinë e luajshme, si më lart.
- Rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2016, pasi nuk justifikon me burime të ligjshme të të ardhurave, shumën 192.189 lekë për blerjen e automjetit në fjalë.

4. Banesë, e ndodhur në fshatin (*) , Plazh, Velipojë,** një kat me sip. rreth 90 m², aktualisht në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t, Drejtoria Turistike²⁴.

Lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar se objekti është ndërtuar me të ardhurat e znj. L. K., të siguruara nga shitja e banesës së ndodhur në qytetin e Gjirokastrës në shkurt të vitit 1996, në vlerën 4.000.000 lekë dhe nga fitimet e realizuara nga

²³ Sipas kontratës së shitjes nr. (***) kol, datë 14.9.2016.

²⁴ Vërtetim nr. (***) , datë 2.12.2016 nga ALUIZNI, Drejtoria Zonat Turistike, ku rezulton se znj. L. K. është subjekt në proces legalizimi, për objekt informal, aplikuar në datën 26.12.2014, me nr. (***) prot., për një objekt pa leje ndërtuar në vitin 2007, i ndodhur në fshatin (***) , Velipojë + deklaratë aplikimi datë 26.12.2014.

Vërtetim nr(***) , datë 26.10.2016, e ISSH-së, ku vërtetohet se znj. L. K. trajtohet me pension pleqërie, me të ardhura nga data 24.6.1988 – 30.10.2016, me të ardhura në total 2.693.218 lekë.

Vendim gjykate nr. (***) , datë 23.1.1996, me objekt “lëshim dëshmi trashëgimie kërkuar nga L. K., me trashëgimlënës P. K., trashëgimtarë të vetëm L. K. dhe Anila Kristani + praktika.

Mandatarkëtimi, Banka e Kursimeve, agjencia bankare nr. 2, Gjirokastrë, arkëtues L. K., transferuar vlerën 4.000.000 lekë, për depozitë në degën e Bankës së Kursimeve, agjencia nr. (***) Tiranë, me afat 6-mujor + mandat nr. (***) , Banka e Kursimeve datë 2.10.1997 + praktika e marrjes së informacionit nga “Raiffeisen Bank”.

Kontratë depozite datë 18.5.2010, me “Raiffeisen Bank”, investitor L. K., të vlerës 4.000.000 lekë, 6 muaj + nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. L. K. për periudhën 14.11.2005 – 15.8.2016 + veprime arke nga znj. L. K. në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 18.5.2010 – 22.11.2013.

Nxjerrje llogarie në emër të znj. L. K. në BKT, për periudhën 1.11.2014 – 12.10.2016.

Vërtetim mbi shpalljen fitues në ankandin e Bankës së Shqipërisë, datë 11.9.2014, me afat 1-vjeçar, të vlerës 4.000.000 lekë.

interesat e përfituara nga dhënia në formën e huas, si depozitë me afat pranë bankave të nivelit të dytë, si dhe duke investuar si bono thesari në Bankën e Shqipërisë, etj. Vlera e pasurisë në përdorim të përkohshëm nga subjekti gjatë vitit është deklaruar në vlerën 2.500.000 lekë.

4.1 Faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Pasuria deklarohet për herë të parë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017. Mbi përdorimin e kësaj pasurie nuk deklarohet në deklaratat periodike, para dhe pas deklaratës “Vetting”. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” faktin e përdorimit të banesës në fshatin (***) të Velipojës, por deklarimi është i paplotë për sa i takon periudhës së përdorimit.

Nga deklarata nr. (***) prot., datë 26.12.2014, “Për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”, rezulton se ndërtimi është bërë në vitin 2007. Komisioni kreu verifikimet nëpërmjet korrespondencës me institucionet përkatëse²⁵. Nga ZVRPP-ja Shkodër nuk konfirmohet asnjë pasuri e llojit “tokë” apo “truall” në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit. Nga ALUIZNI, Zonat Turistike, konfirmohet administrimi i praktikës me nr. (***) prot., datë 26.12.2014, në emër të vetëdeklarueses L. Q. K., për të cilën është lëshuar leja e legalizimit nr. (***), datë 17.8.2018, ku janë pasqyruar të dhënat e ndërtimit të legalizuar: sip. e zënë: 289,05 m²; sip. ndërtimi (në bazë) 96,35 m²; sip. ndërtimi (totale): 120,66 m²; numër katesh: 1 kat mbi tokë; viti i ndërtimit 2007.

Bazuar pikën 14, të nenit 3, dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi se shtetasja L. K. plotëson kriteret ligjore për t’u kualifikuar si “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit. Lidhur me këtë fakti subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Ky është një konstatim i saktë (kupto: konstatimin e Komisionit se subjekti ka deklaruar saktë faktin e përdorimit të shtëpisë), pasi kam deklaruar se e përdor për pushime dhe më lejoni që lidhur me kohën e përdorimit të sqaroj se e kemi përdorur vetëm për pushime verore gjatë muajit gusht.*

Duke qenë se ligji nr. 84, datë 30.8.2016, dhe udhëzimi nr. 4, datë 10.10.2016, nuk bëjnë ndonjë përcaktim konkret lidhur me faktin se cila mund të jetë periudha minimale e përdorimit të një prone me qëllim që në vlerësim të ligjit të konsiderohesh përdorues i saj, unë vlerësova se kisha detyrimin ligjor që të bëj dhe këtë deklaram.

Por, nisur dhe nga rregullimi që udhëzimi nr. 4, datë 10.10.2016 bën, lidhur me detyrimin për të deklaruar pasuritë në përdorim, ku parashikon se marrëdhënia e përdorimit duhet të vërtetohet me dokumentacionin justifikues ligjor, mund të arrijmë në përfundimin se ligji nuk e ka pasur detyrim që unë të deklaroj përdorimin vetëm për pushimet vjetore disa ditore të një prone të një personi me të cilin jam në marrëdhënie të posaçme familjare.

Vlerësoj se në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe akteve nënligjore, si dhe fakteve të konstatuara, përfshirja në procesin e verifikimit të kësaj pasurie nuk është e bazuar në ligj”.

Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara dhe të kuadrit ligjor në fuqi, çmon se detyrimi i subjektit për të deklaruar të drejtat reale mbi pasurinë ka lindur që në vitin 2007 (viti i krijimit), sipas germës “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas të cilit: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në*

²⁵ Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. ZVRPP-ja Shkodër ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 4.3.2019.

Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t. Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 4.2.2019.

ALUIZNI, Zonat Turistike, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 11.2.2019.

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive...: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to”.

Për sa më sipër, Komisioni çmon se deklarimi është i saktë për të drejtën e përdorimit vetëm në deklaratën “Vetting”. Komisioni çmon se deklarimi është i pamjaftueshëm për të drejtën e përdorimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore nga viti 2007 deri në vitin 2016.

Lidhur mbi pronësinë e truallit mbi të cilin është ndërtuar banesa

Komisioni, në vijim të mungesës së dokumentacionit ligjor mbi pronësisë e truallit ku është ndërtuar banesa, iu drejtua subjektit duke i kërkuar shpjegimet përkatëse, e cila, ndër të tjera, shpjegoi: *“Trualli në dijeni time në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme figuron në pronësi shtet. Trualli ku është ndërtuar banesa e znj. L. K. pretendohet nga trashëgimtarët e ish-pronarit të shpronësuar z. Z. K. Gj., i cili ka pasur në pronësi të tij një sipërfaqe toke rreth 300 dynym të ndodhur në (***) , Velipojë. Trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar z. Z. K. Gj. kanë aplikuar pranë organeve kompetente, por nuk kanë mundur të sigurojnë dokumentacion ligjor të saktë lidhur me këtë fakt”.*

Për sa më sipër, nga hetimi rezultoi e provuar se kjo sipërfaqe toke është blerë në vijim të procedurës të nisur nga znj. L. K. .

Lidhur me vlerën e ndërtimit

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se ndërtimi në fjalë ka kushtuar 2.500.000 lekë, ndërsa mobilimi është realizuar me riciklimin e mobilieve dhe pajisjeve të përdorura të të afërmeve.

Subjekti ka dhënë shpjegime për sa i takon vlerës së pasurisë së deklaruar në përdorim. Në mbështetje të deklarimit të saj, subjekti ka porositur kryerjen e një aktvlerësimi nga një ekspert vlerësues i pasurive, i cili ka hartuar aktin datë 15.03.2019, të bashkëlidhur me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

Nga aktvlerësimi në fjalë, konstatohet se në përcaktimin e metodologjisë apo mënyrës së përlllogaritjes së çmimeve të punimeve të ndërtimit, eksperti bazohet në dy burime: çmimi i ndërtimit të objektit sipas Udhëzimit Nr. 2, datë 4.4.2007, të KM-së (si më sipër) dhe çmimi i ndërtimit të objektit sipas preventivit të punimeve dhe manualit të çmimeve për punimet e ndërtimit.

Në përfundim, eksperti vlerësues paraqet opinionin e tij bazuar vetëm në burimin e dytë, për të cilin shpreh rezerva, për shkak se bazohet vetëm në deklaratimet e palës investitore, znj. L. K. .

Subjekti, ndër të tjera, shpjegon: *“Është i vërtetë fakti se është deklaruar një vlerë e banesës prej 2.500.000 lekësh, por dua të nënvizoj faktin se unë i jam përgjigjur kësaj pyetjeje nën vlerësimin se duhet të jap një përgjigje konkrete lidhur me vlerën e saj, ndërkohë që asnjëherë nuk kam pasur një informacion të saktë lidhur me këtë gjë. Përgjigjja e një pyetjeje të tillë do të bënte sens nëse unë do të kisha dijeni nga ndonjë akt zyrtar lidhur me shumën e shpenzuar për ndërtimin e saj.*

*Nuk jam dakord me konstatimin e bërë, sipas të cilit banesa ka një sipërfaqe prej 120,66 m². Banesa është legalizuar me lejen e legalizimit nr. (***) , datë 17.8.2018, në të cilën përcaktohet se sipërfaqja ndërtimore është 96,35 m² dhe sipërfaqja prej 24.31 m² është verandë. Dhe në planimetrinë që shoqëron dokumentacionin e hartuar nga ALUIZNI, pasqyrohet qartë fakti se sipërfaqja ndërtimore është 96.35 m². Sipërfaqja që emërtohet verandë prej 24.31 m² është një sipërfaqe e hapur nga të tre anët, pa asnjë lloj rrethimi dhe mbulimi dhe vetëm është shtruar me pllaka...*

Aktualisht, nga ish-ZVRPP-ja Shkodër është lëshuar dhe certifikata për vërtetim pronësie, e cila ka të përcaktuar se sipërfaqja totale e pasurisë është 96,35 m², dhe nga kjo, ndërtesë është 96,35 m²”.

Në vijim subjekti shpjegon: “Bazuar në parashikimet e bëra nga Udhëzimi Nr. 2, datë 4.4.2007, ‘Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave’, lidhur me koston mesatare të ndërtimit për rrethin e Shkodrës, ju keni përcaktuar se ajo është 30.001 lekë/m². Referuar parashikimit të bërë në Udhëzimin Nr. 2, datë 4.4.2007, në tabelën nr. 1 të tij është përcaktuar se:

Për rrethin e Shkodrës

- kostoja mesatare për sipërfaqe shfrytëzimi është 30.001 lekë/m²;
- kostoja mesatare për sipërfaqe ndërtimore është 25.072 lekë/m².

Në vlerësimin tuaj ju i referoheni vlerës për sipërfaqe shfrytëzimi, kjo është e gabuar.

Sipërfaqe ndërtimit = sipërfaqe shfrytëzimi + sipërfaqe të përbashkëta.

Pra, sipërfaqja e shfrytëzimit përfshin edhe sipërfaqet në bashkëpronësi, dhe gjen aplikim në rastin e ndërtesave me bashkëpronësi të detyrueshme si pallatet etj. Në rastin konkret të një banese të veçuar nuk ka arsye dhe është e gabuar që t’i referohemi vlerës që përcaktohet për sipërfaqet e shfrytëzueshme.

Në këto rrethana vlerësoj se kosto mesatare për 1 m² ndërtimi duhet t’i referohet vlerës prej 25.072 lekë/m². Lidhur me sipërfaqen ndërtimore verandë, vlera e saj mund të llogaritet sa 30 % e vlerës së 1 m² sipërfaqe ndërtimore.

Mund t’i referohemi për këtë qëllim parashikimeve që bën udhëzimi nr. 9, datë 26.2.2008, i cili bën një përcaktim të vlerës së sipërfaqes ndërtimore bazuar në koston minimale, ku në përmbajtje të tij është përcaktuar se: ‘Çmimi për një metër katror ndërtim parkim i hapur është 30 % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas zonave’.

Në rastin tonë nuk kemi parkim, por pavarësisht funksionit dhe kjo sipërfaqe e quajtur verandë, nga pikëpamja fizike është një sipërfaqe e hapur e shtruar me pllaka të thjeshta.

Duke pasur parasysh prapësimet e mësipërme, vlerësoj se do të kishim një vlerësim të banesës si më poshtë:

- 96,35 m² sipërfaqe ndërtimore x 25.072 lekë/m² kosto mesatare = 2.415.687 lekë;
- 24,31 m² sipërfaqe ndërtimore x 25.072 lekë/m² kosto mesatare = 609.500 lekë;
- 609.500 lekë x 30 % = 182.850 lekë;
- 2 415.687 lekë + 182.850 lekë = 2 598.537 lekë.”

Komisioni çmon se, në analizë të provave, kuadrit ligjor në fuqi dhe prapësimeve të mësipërme, në rastin objekt gjykimi, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të drejta lidhur me vlerën referuese të ndërtimit të shtëpisë në emër të nënës së saj, duke pranuar si vlerë 2.598.537 lekë, me qëllim analizën e burimit të ligjshëm të krijimit të saj.

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie nga znj. L. K.

Në deklaratën “Vetting” subjekti shpjegon burimin: “...ndërtuar me të ardhurat e znj. L. K., të siguruara nga shitja e banesës së ndodhur në qytetin e Gjirokastrës në muajin shkurt 1996, në vlerën prej 4.000.000 lekësh dhe fitimet e realizuara nga interesat e përfituara nga dhënia në formën e huas, si depozitë me afat pranë bankave të nivelit të dytë, si dhe duke investuar si bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë...”, etj.

Komisioni, me qëllim analizimin e burimit të ligjshëm, kreu verifikimet mbi burimet financiare dhe aktivitetet e mundshme tregtare, nëpërmjet korrespondencës me institucionet²⁶.

²⁶ Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; “Raiffeisen Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 1.2.2019; Banka e Shqipërisë ka kthyer përgjigje me shkresën nr(***) prot., datë 30.1.2019; BKT-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2019.

Nga të dhënat e siguruara nga përgjigjet e mësipërme rezulton se nëna e subjektit, znj. L. K., nuk ka ushtruar asnjë aktivitet tregtar në periudhën e ndërtimit të shtëpisë dhe as ka zotëruar aksione apo kuota në ndonjë subjekt tregtar sh.a. apo sh.p.k. “Raiffeisen Bank” konfirmon llogaritë e saj, të hapura në vitin 2005.

Rezulton e provuar se znj. L. K. ka shitur një banesë në vitin 1996, të ardhurat e të cilës rezulton t’i ketë depozituar në Bankën e Kursimeve.

Në përgjigjet e pyetësorit të dytë, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit një përgjigje me shkrim nga “Raiffeisen Bank”²⁷, nga e cila rezulton se znj. L. K. ka pasur dy depozita me afat, të çelura pranë ish-Bankës së Kursimeve në datën 9.9.1996, por pa informacion të detajuar se si janë tërhequr prej saj interesat nga këto depozita.

Rezulton e provuar se deri në fund të vitit 2003 gjendja e këtyre depozitave ka qenë në shumën rreth 5.000.000 lekë dhe, sipas kësaj shkrese, duket se interesat janë tërhequr nga znj. L. K. gjatë kësaj periudhe.

Interesat e depozitave gjatë kësaj periudhe, dhe kryesisht për periudhën 1996 – 1999, kanë qenë në vlera të konsiderueshme dhe nisur nga informacioni i Bankës së Shqipërisë lidhur me normat e interesave për këtë periudhë, nëna e subjektit duket se ka përfituar të ardhura të konsiderueshme nga interesat e kësaj depozite. Ky informacion nuk është i plotë për të gjithë periudhën dhe, po sipas vërtetimit të datës 26.3.2019, banka nuk ka informacion lidhur me tërheqjet e kryera nga kjo depozitë²⁸.

Gjithashtu, rezulton e provuar se nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur një llogari depozite në “Raiffeisen Bank”, e cila ka qenë aktive deri në shtator të vitit 2014, në shumën rreth 4.000.000 lekë. Në shtator të vitit 2014 kjo shumë është investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, në të cilën investimi në bono thesari vazhdon të qëndrojë i paprekur deri në tetor të vitit 2018 në shumën prej 3.933.278 lekësh.

Nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore rezulton se nëna e subjektit të rivlerësimit znj. L. K., përfiton pension pleqërie që nga maji i vitit 1988²⁹.

Në përfundim në analizë të gjitha fakteve dhe rrethanave rezulton e provuar se znj. L. K. ka pasur mundësi financiare për të realizuar investimin e bërë.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arriti në konkluzionin se:

→ Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, pasi nuk rezulton e deklaruar në deklaratën periodike të pasurive të viteve 2007 – 2016 e drejta reale e përdorimit të kësaj pasurie.

Lidhur me depozitat bankare të subjektit të rivlerësimit, rezulton si më poshtë vijon:

Kërkesë nr. (***) (bis) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike; OSHEE-ja sh.a. ka thyer përgjigje me shkresën nr. (***) (bis) prot., datë 22.1.2019.

Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit; QKB-ja ka thyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 14.2.2019.

Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; DPT-ja ka thyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 31.1.2019.

27 Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 26.3.2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e “Raiffeisen Bank”.

28 Shihni vërtetimin nr. (***) prot., datë 26.3.2019, të lëshuar nga “Raiffeisen Bank” sh.a., një tabelë mbi interesat e depozitave të kësaj banke, si dhe një informacion që “Raiffeisen Bank” sh.a., disponon për periudhën nga koha e fillimit të veprimtarisë së saj në vend.

29 Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 31.1.2019.

5. Depozitë me nr. llogarie (*)³⁰, në “Raiffeisen Bank” sh.a., Tiranë, në emër të znj. Anila Guri.** Në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj depozite subjekti ka deklaruar se e ka krijuar ndër vite nga kursimet e të ardhurave të fituara nga puna e saj dhe e bashkëshortit.

Vlera e deklaruar: 21.217 USD.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht

Subjekti, në lidhje me këtë llogari bankare, deklaron në të dhënat konfidenciale të deklaratës së pasurive të vitit 2006. “Raiffeisen Bank” konfirmon se subjekti i rivlerësimit zotëron depozitë në llogari bankare³¹, me gjendje në vlerën 21.217 USD³². Rezulton se deklarimi i subjektit në deklaraten “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga “Raiffeisen Bank”.

Nga dokumenti i administruar ka rezultuar se kjo depozitë është çelur që në nëntor të vitit 2005 (shumë e cila rezulton të ketë ardhur nëpërmjet një transferte bankare nga Banka e Kursimeve), në shumën 4.000 USD.

Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2004 dhe 2005 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar kursimet dhe për të mbuluar shpenzimet në këto dy vite.

Në funksion të analizës së burimit të ligjshëm të krijimit të këtij likuiditeti rezultoi se subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 kishte qëndruar për një kohë të gjatë në shtetin amerikan dhe rezultonte se kishte lindur djalin në vitin 2006 në këtë shtet. Subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion ligjor provues lidhur me shpenzimet e kryera për lindjen e djalit.

Në përgjigje të pyetësorit, subjekti deklaroi se nuk kishte kryer shpenzime lidhur me kujdesin shëndetësor në SHBA dhe se kishte kryer vetëm shpenzimet e udhëtimit, pasi shpenzimet e qëndrimit u mbuluan nga xhaxhai i bashkëshortit të saj. Subjekti nuk depozitoi dokumentacion ligjor të plotë lidhur me marrëdhënien me spitalin ku ajo ka lindur, detyrimet financiare ndaj tij dhe subjektin që ka përbulluar shpenzimet spitalore.

Në lidhje me sa më sipër, në analizën financiare të vitit 2006, janë përfshirë vetëm shpenzimet udhëtimit.

Sipas analizës financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera në vitin 2006.

Gjithashtu, rezulton se subjekti ka bërë deklaram të paplotë të gjendjes financiare të vitit 2006, lidhur me marrëdhënien me spitalin ku ajo ka lindur, detyrimet financiare ndaj tij dhe në lidhje me përballimin e shpenzimeve spitalore prej saj.

Në lidhje me sa më sipër, në prapësimet ndaj rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar: *“Në datën 17.5.2019 i jam drejtuar në adresën e postës elektronike spitalit, në adresën fax (***), me një kërkesë për të më mundësuar marrjen e një informacioni të tillë, por deri më sot nuk më kanë kthyer përgjigje.*

³⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën, kontratë depozite me afat, lidhur në datën 1.9.2016, mes Anila Guri dhe “Raiffeisen Bank”, investuar vlera 21.217 USD.

³¹ Me nr. llogarie nr. (***) , në monedhën USD, të çelur në datën 7.11.2005.

³² Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; “Raiffeisen Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 1.2.2019, me gjendje në datën 30.1.2017.

E ndihmuar dhe nga një e afërme imja, shtetasja e quajtur E. G.³⁷, unë i jam drejtuar spitalit me kërkesë nëpërmjet postës elektronike, e-mail, për të më vënë në dispozicion këtë informacion, duke plotësuar për këtë qëllim dhe një formular të posaçëm 'Authorization for Release of Health Information, datë 30.5.2019 , por nuk kam marrë asnjë lloj përgjigjeje³⁸.

Unë vlerësoj se kam bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të bërë të mundur sigurimin e këtij informacioni, dhe mosparaqitja e tij vlerësoj se nuk varet nga qëndrimi im subjektiv, por është për shkaqe të arsyeshme, dhe bazuar në provat që kam paraqitur lidhur me këtë fakt vlerësoj se kam arritur në nivel besueshmërie në pretendimin tim se, unë personalisht nuk kam bërë shpenzime lidhur me kujdesin shëndetësor në SHBA për lindjen e fëmijës K. G.”.

Subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si më sipër edhe në seancën dëgjimore.

Në lidhje me pretendimin e afatit të shkurtër me gjithë përpjekjet e subjektit të rivlerësimit, për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm për të provuar faktet e kërkuara nga Komisioni gjatë hetimit

Viti	2006
Pasuri	-23,902
Shtesa/pakësime likuiditete cash dhe bankë	-23,902
Pasuri neto	-23,902
Të ardhura	386,527
Të ardhura nga punësimi, subjekti	374,995
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave	11,532
Shpenzime	844,697
Shpenzime jetese ³³	401,761
Shpenzime udhëtimit ³⁴	369,872
Shpenzimet e lindjes së djalit ³⁵	xxxxxx
Shpenzimet e qëndrimit në shtetin amerikan ³⁶	73,064
Të ardhura – Shpenzime – Pasuri	- 434,268

administrativ, Komisioni ka në vëmendje faktin se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në datën 30.1.2017 deklaratën e pasurive dhe interesave për rivlerësimin kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016.

Pa llogaritur momentin në të cilin subjekti ka marrë dijëni mbi dispozitat e këtij ligji apo momentin në të cilin sipas ligjit prezumohet se ka dijëni, subjekti i rivlerësimit duhej të kishte nisur më herët

³³ Subjekti pretendoi pas dërgimit të rezultateve të hetimit që t'i zbriten shpenzimet e jetesës në Shqipëri për periudhën gjatë së cilës ka qëndruar në shtetin amerikan. Trupi gjykues çmoi që ta marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe u zbritën shpenzimet e jetesës në Shqipëri për një periudhë prej 2,5 muaj për subjektin dhe djalin e saj, periudhë gjatë të cilës kanë jetuar në SHBA. Shpenzimet e jetesës për këtë vit në Shqipëri janë konsideruar në shumën 401.761 lekë.

³⁴ Në shpenzimet e udhëtimit Komisioni ka përfshirë vetëm biletat e udhëtimit lidhur me udhëtimin në SHBA.

³⁵ Edhe pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit nuk vuri në dispozicion të Komisionit asnjë dokument ligjor provues apo ndonjë të dhënë tjetër lidhur me shpenzimet e lindjes së djalit në shtetin amerikan. Komisioni çmoi që të mos vendosë shpenzime për lindjen e djalit në mungesë të të dhënave.

³⁶ Trupi gjykues vendosi që shpenzimet e qëndrimit në shtetin amerikan për subjektin e rivlerësimit të vendosen 10 USD / ditë * 78 ditë = 780 USD, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të vitit 2006 sipas Bankës së Shqipërisë, në shumën 73.064 lekë.

³⁷ “Ju drejtova kësaj të afërmeje për faktin se ajo prej shumë vitesh është rezidente e ligjshme në SHBA (punon pranë Bashkisë New York dhe një natyrisht më mirë legjislacionin vendas) .

³⁸ Ju lutem shikoni formularin që i kam dërguar spitalit në adresën e tyre elektronike, konfirmin nëpërmjet postës elektronike që e kanë marrë dhe korrespondencën time nëpërmjet postës elektronike (e-mail) me të afërmen time, znj. E. G. .”

përpjekjet për të siguruar informacionin mbi: raportin juridik me institucionin shëndetësor në SHBA në të cilin lindi djalit; detyrimin financiar deri në ditën e përfundimit të qëndrimit në institucionin shëndetësor; personin apo subjektin që përballoi shpenzimet e lindjes; si dhe dokumentacionin provues. Subjekti mund ta kishte bërë këtë që përpara nënshkrimit dhe dorëzimit të deklaratës së pasurisë dhe interesave “Vetting” të vitit 2017.

Gjithashtu, në pyetësonin nr. 3, datë 19.4.2019, Komisioni ka kërkuar në mënyrë specifike deklarime dhe dokumentacion ligjor mbi lindjen e djalit në SHBA, sikurse më sipër, ndërsa subjekti i rivlerësimit shoqëron përgjigjen (ku deklaroi se nuk ka kryer shpenzime në SHBA për lindjen e djalit) me një deklaratë ollografe, mbi një shkresë të thjeshtë, nga e cila nënshkruesi vetidentifikohet si shtetasi N. D. G. (xhaxhai i bashkëshortit të subjektit), ku prej të cilit deklarohet se çdo shpenzim e ka përballuar ky i fundit³⁹. Por, në këtë deklaratë (që nuk përmban elementë të mjaftueshëm për t’u konsideruar si dokument me fuqi të plotë provuese – dhe as nuk është shoqëruar me kopjen e ndonjë dokumenti identifikimi të deklaruesit) – nuk evidentohet asnjë element që të përbëjë ndonjë provë për të vërtetuar atë që Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit mbi shpenzimet gjatë qëndrimit në SHBA.

Në të tilla rrethana, Komisioni çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për një afat të shkurtër për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm, edhe pse pretendohet se bëri çdo përpjekje, nuk qëndron dhe është i pajustificuar me mosveprimin në kohën e duhur për këtë qëllim.

Përfundimisht, Komisioni konkludon se shpenzimet spitalore, konkretisht mbetën në vlerën zero, jo si pasojë e moskryerjes së tyre apo si rezultat i një prove mbi moskryerjen e shpenzimeve nga subjekti, por si pasojë e mungesës së provave apo *indicieve* që Komisioni, në bazë të të cilave, do t’i përfshinte në analizën financiare me një vlerë të caktuar. Kjo situatë rrodhi për shkak të mosaktivizimit në kohën dhe mënyrën e duhur të subjektit për të provuar bindshëm, së pari, shumën e paguar për shërbimet spitalore dhe, së dyti, burimin financiar që kishte mundësuar pagesat e kryera.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera në vitin 2006 (siç përshkruhet në tabelën e mësipërme), në shumën 434.268 lekë.
- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të paplotë të gjendjes financiare të vitit 2006 lidhur me marrëdhënien me spitalin ku ka lindur, duke mos specifikuar dhe provuar: (i) shumën që lidhej me detyrimet financiare për shërbimet spitalore në fjalë; (ii) personin që ka përballuar këto shpenzime; (iii) burimin financiar që kishte mundësuar pagesat e shërbimeve spitalore.

6. Depozitë me nr. llogarie (*)⁴⁰ në “Credins Bank” sh.a., Tiranë, në emër të znj. Anila Guri.**

Burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë: krijuar ndër vite nga kursimi i të ardhurave të fituara nga subjekti dhe bashkëshorti.

Vlera: 2.206.580 lekë.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

³⁹ Shihni deklaratën e dorës me deklarues N. D. G. (nr. rendor 11 në listën e listën e akteve, regjistruar në Komision me nr. (***) prot., datë 23.4.2019)

⁴⁰ Kontratë depozite me afat, lidhur në datën 24.11.2016, mes znj. Anila Guri dhe “Credins Bank”, investuar vlera 2.206.580 lekë.

Viti	2015
Pasuri	862,931
Shtesa/pakësime likuiditete <i>cash</i> dhe bankë	862,931
Pasuri neto	862,931
Të ardhura	1,976,889
Të ardhura nga punësimi, subjekti	1,348,847
Të ardhura nga punësimi, bashkëshorti	585,608
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave	42,434
Shpenzime	1,235,723
Shpenzime jetese	897,104
Shpenzime udhëtimit	338,619
Të ardhura – Shpenzime – Pasuri	- 121,764

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht⁴¹

Kjo depozitë është çelur në vitin 2015 me një afat 1-vjeçar, duke depozituar fillimisht shumën prej 2.000.000 lekësh. Ecuria e kësaj depozite është e pasqyruar në tabelën në vijim. Në vitin 2017 kjo llogari është ndarë në dy llogari depozite: njëra në emër të subjektit me afat 6-mujor, në shumën 1.406.580 lekë; dhe llogaria tjetër është një llogari depozite dyemërore e çelur në vitin 2016, në shumën 342.040 lekë.

Rezulton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat bankare. “Credins Bank” konfirmon se subjekti i rivlerësimit disponon depozitë në llogari bankare në monedhën lekë.

Deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga “Credins Bank”.

→ Sipas analizës financiare të kryer duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të justifikuar çeljen e depozitës prej 2.000.000 lekësh shtesë në “Credins Bank”. Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 121.764 lekë.

7. Depozitë me nr. llogarie (*)⁴², në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a., Tiranë, në emër të znj. Anila Guri.** Burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë: krijuar ndër vite nga kursimi i të ardhurave të fituara nga subjekti dhe bashkëshortit.

Vlera: 24.989 euro.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

Faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Kjo depozitë është çelur në korrik të vitit 2010 dhe fillimisht në këtë llogari është depozituar shuma 10.000 euro. Subjekti e deklaroi këtë llogari bankare në deklaratën e pasurive të vitit 2010.

⁴¹ Kërkesë nr. (***)prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; “Credins Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***)prot., datë 20.2.2019.

⁴² Kontratë depozite me afat, lidhur në datën 6.9.2016, mes znj. Anila Guri dhe BKT-së, investuar vlera 24.989 euro.

“Banka Kombëtare Tregtare” konfirmon se subjekti i rivlerësimit disponon depozitë në llogari bankare në monedhën lekë⁴³.

Rezulton se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga “Banka Kombëtare Tregtare”.

Nga informacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nga bankat e nivelit të dytë rezulton se në datën 10.3.2010 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga “Raiffeisen Bank” depozitën prej 4.378 euro.

Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2010 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën në kursimet dhe për të mbuluar shpenzimet e realizuara.

Mënyra se si ka evoluar kjo llogari që nga momenti i çeljes dhe deri më tani është e pasqyruar në tabelën e mëposhtme (të depozitave të llogarive bankare).

8. Depozitë me nr. llogarie (*)**, në “**Bankën Kombëtare Tregtare**” sh.a., Tiranë, në emër të **znj. Anila Guri**. Burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë: krijuar ndër vite nga kursimi i të ardhurave të subjektit dhe të bashkëshortit.

Vlera: 298.339 lekë.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

Faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Kjo depozitë është çelur në qershor të vitit 2010 dhe fillimisht në këtë llogari është depozituar shuma 500.000 lekë dhe është çelur një depozitë me afat 6-mujor.

Subjekti e deklaron këtë llogari bankare në kuadër të deklaratës së pasurive të vitit 2010. BKT-ja konfirmon se subjekti i rivlerësimit disponon depozitë në llogari bankare në monedhën lekë⁴⁴. Rezulton se subjekti i ka deklaruar saktë të dhënat si në DPV-në e vitit 2010, ashtu dhe në deklaratën “Vetting”.

Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2010 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën në kursimet dhe për të mbuluar shpenzimet e realizuara.

9. Depozitë me nr. llogarie (*)⁴⁵**, në “**Credins Bank**” sh.a., Tiranë, në emër të **znj. Anila Guri**. Burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë: të ardhura të siguruar nga puna e subjektit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vlera: 478.709 lekë.

Pjesa takuese: 50 % me bashkëshortin.

Faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Kjo depozitë është çelur në qershor të vitit 2016, fillimisht në shumën 342.040 lekë, me afat 6-mujor. Subjekti e deklaron këtë llogari bankare në deklaratën e pasurive të vitit 2013. Komisioni ka

⁴³ Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; BKT-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***)prot., datë 12.2.2019.

⁴⁴ Kërkesë nr. (***)prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; BKT-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2019.

⁴⁵ Nxjerrje llogarie datë 25.1.2017, nga “Credins Bank”, në emër të znj. Anila Guri, me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 478.709 lekë.

hetuar lidhur me këtë llogari bankare⁴⁶. “Credins Bank” konfirmon se subjekti i rivlerësimit disponon depozitë në llogari bankare në monedhën lekë.

Rezulton se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga “Credins Bank”.

Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën në kursimet dhe për të mbuluar shpenzimet e realizuara.

10. Depozitë e llojit “(*)” me nr. llogarie (***)⁴⁷, në “Credins Bank” sh.a., Tiranë, në emër të fëmijës së mitur, Kevin Guri.** Burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë: të ardhura të krijuara nga kursimet, nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit.

Vlera: 357.040 lekë.

Pjesa takuese: 50 % me bashkëshortin.

Faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Kjo depozitë, ku fillimisht është depozituar shuma 50.000 lekë me afat 6-mujor, është çelur në qershor të vitit 2016.

Komisioni hetoi mbi këtë llogari bankare⁴⁸, të cilën subjekti e ka deklaruar në deklaratën e pasurive të vitit 2016. “Credins Bank” konfirmon depozitën e llojit “(***)” në llogari bankare në monedhën lekë.

Rezulton se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga “Credins Bank”.

11. Depozitë me nr. llogarie (*)⁴⁹, në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a., Tiranë, në emër të z. D. G., person fizik.** Burimi i të ardhurave: të ardhura të krijuara në vlerën 338.122 lekë, nga puna e bashkëshortit si avokat në Dhomën e Avokatisë, Tiranë.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

Faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Komisioni hetoi mbi këtë llogari bankare⁵⁰, për të cilën subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurive të vitit 2017.

Rezulton se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga BKT-ja.

⁴⁶ Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; “Credins Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 20.2.2019.

⁴⁷ Nxjerrje llogarie datë 25.1.2017, në emër të znj. Anila Guri, me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 357.040 lekë, nga “Credins Bank”.

Kontratë depozite me afat, datë 24.6.2016, investuar vlera 250.000 lekë, lidhur nga znj. Anila Guri me “Credins Bank”.

⁴⁸ Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; “Credins Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 20.2.2019.

⁴⁹ Nxjerrje llogarie datë. 26.1.2017, në emër të z. D. G., llogari person fizik, me gjendje në datën 4.1.2017, në vlerën 338.122 lekë, nga “Banka Kombëtare Tregtare”.

⁵⁰ Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; BKT-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2019.

12. Depozitë me nr. llogarie (*)⁵¹, në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a., Tiranë, në emër të z. D. G. .** Burimi i të ardhurave për krijimin e pasurisë: të ardhura në vlerën 76.920 lekë, të krijuara nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit.

Pjesa takuese: 50/50 me bashkëshortin.

Faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ

Kjo llogari është çelur fillimisht në janar të vitit 2012 në të cilën është depozituar shuma 100.000 lekë.

Subjekti e ka deklaruar këtë llogari bankare në kuadër të deklaratës së pasurive të vitit 2017.

Komisioni hetoi mbi këtë llogari bankare⁵² dhe rezulton se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga BKT-ja.

Mënyra se si ka evoluar kjo llogari që nga momenti i çeljes dhe deri më tani është e pasqyruar në tabelën e mëposhtme (të depozitave të llogarive bankare).

Në vijim paraqitet analiza financiare ndër vite, për subjektin e rivlerësimit, e cila lidhet me analizën e burimit të ligjshëm të krijimit të likuiditeteve në bankë, të deklaruara në deklaratën “Vetting”.

Në vijim gjendet tabela lidhur me pasqyrimin se si kanë evoluar llogaritë bankare të deklaruara.

ANALIZA FINANCIARE

Në analizën financiare të mëposhtme janë paraqitur të ardhurat, shpenzimet, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, likuiditetet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në momentin e dërgimit të rezultateve të hetimit.

⁵¹ Nxjerrje llogarie datë 26.1.2017, në emër të z. D. G., me gjendje datë 1.1.2017, në vlerën 76.920 lekë dhe me gjendje 0 euro, nga BKT-ja.

⁵² Kërkesë nr. (***) prot., datë 22.1.2019, drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare; BKT-ja ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2019.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Pasuri	-23,902	-116,813	1,269,359	1,895,624	301,009	815,967	712,593	1,806,409	266,358	1,902,930	1,834,617
Tokë truall 1000 m ² Rr. **** Tiranë											
Banesë 2 kate + papafingo											
Autoveturë Benz me targë ***											
Banesë e ndodhur në plazh ***, Velipojë											
Automjet "Land Rover"				900,000							
Automjet Golf Volkswagen i blerë në vitin 2010					500,000						
Automjet tip Mercedes Benz											946,890
Shtesa/pakësime likuiditete CASH dhe bankë	-23,902	-116,813	1,269,359	995,624	-198,991	815,967	712,593	1,806,409	266,358	1,902,930	887,727
Total likuiditete	978,812	862,000	2,131,359	3,126,982	2,927,992	3,743,959	4,456,551	6,262,960	6,529,319	8,432,249	9,319,976
Detyrime	0	0	0	0	0	0	0	570,000	0	0	-570,000
Hua e marrë shtetasit L.T me datë 03.05.2013								280,000			-280,000
Hua e marrë shtetasit L.T me datë 07.08.2013								290,000			-290,000
Pasuri neto	-23,902	-116,813	1,269,359	1,895,624	301,009	815,967	712,593	1,236,409	266,358	1,902,930	2,404,617
Të ardhurat	386,527	851,859	2,478,367	2,108,683	2,331,761	1,510,587	1,165,350	2,330,413	2,900,440	1,976,889	4,757,136
Të ardhura nga punësimi subjekti	374,995	840,088	830,484	988,084	1,036,524	1,015,827	1,010,145	1,086,029	1,315,258	1,348,847	1,358,609
Të ardhura nga punësimi bashkëshorti	0	0	901,800	441,000	1,152,000	421,232	-32,823	599,750	1,556,108	585,608	1,678,732
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave	11,532	11,771	23,002	129,599	143,237	73,528	78,028	74,634	29,074	42,434	
Të ardhura nga shitja e automjetit Benz				550,000							
Të ardhura nga shitja e automjetit Land Rover											1,149,795
Të ardhura të dhuruara nga nëna e subjektit L.K							110,000	70,000			
Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor për D.G			723,081								
Të ardhura të dhuruara bashkëshortit nga L.T								500,000			
E ardhur nga L.T (falur huaja 280.000 dhe 290.000)											570,000
Shpenzime	808,100	1,324,739	812,554	1,007,371	581,183	1,016,700	916,190	1,009,964	1,678,619	1,235,723	1,826,387
Shpenzime shkollimi për fëmijët											445,038
Shpenzime jetese	438,228	943,872	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	369,872	380,867	266,074	460,891	34,703	470,220	352,094	445,868	798,627	338,619	440,980
Të ardhura - Pasuri - Shpenzime	-397,671	-356,066	396,454	-794,312	1,449,569	-322,080	-463,433	84,040	955,462	-1,161,764	526,133

Likuiditete në Bankë sipas viteve		2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Kursi i këmbimit	euro	133.65	126.74	122.54	123.70	120.91	123.18	137.17	138.81	138.30	139.72	140.21	140.11	137.65	135.27
	usd	108.69	94.58	103.33	93.67	83.03	90.96	93.98	104.95	105.08	106.57	102.38	113.64	126.64	128.29
Raiffeisen Bank		0	628,964	890,925	780,846	828,320	2,088,244	3,088,074	993,845	959,729	1,174,976	1,329,516	2,007,985	2,747,721	2,946,515
Anila Guri	lekë			107,492	-26,802	54,498	159,233	47,820							
Anila Guri	lekë						800,000	1,000,000							
Anila Guri	lekë							442,250							
Anila Guri	euro		2,500	3,007	3,500	3,547	5,116	4,350							
Anila Guri	usd		3,300	4,016	4,000	4,154	5,154	9,995	7,640	8,760	10,978	12,978	16,183	21,217	21,217
Anila Guri	usd							84							
D.G	lekë						30,001	6,627	5,427	39,228	5,028	829	9,932	9,933	33,786
D.G	euro												1,132	366	1,407
K.G	lekë							20,116	62,548				440	440	440
K.G	lekë							35,243	115,243						
Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a		0	0	0	205,235	42,843	43,115	38,908	36,523	-3,888	0	0	0	0	0
Anila Guri	usd				0										
D.G	usd				2,191	516	474	414	348	-37					
Bankës së Shqipërisë		0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,040,000	1,040,000	0	0	0
Anila Guri	lekë										1,040,000	1,040,000			
Bankës Procredit sh.a		0	0	-5,810	-7,368	-9,164	0	0	0	0	0	0	0	0	0
D.G	lekë			-5,810	-7,368	-9,164	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bankës Kombëtare Tregtare sh.a		0	0	0	0	0	0	0	1,897,539	2,678,804	2,229,883	3,186,010	3,892,919	3,667,439	3,457,317
Anila Guri	lekë								500,000	815,903	866,156	878,818	497,493	0	0
Anila Guri	euro								10,068	13,470	15,597	15,997	20,706	22,959	24,990
D.G	euro										143	131	120	8	0
D.G	lekë										30,690	58,547	96,170	8,538	76,920
Bankës Credins sh.a		0	0	117,599	99	0	0	0	85	109,314	11,692	707,434	628,415	2,017,090	2,916,144
Anila Guri	lekë								85	109,314	11,692	293,989	628,415	17,090	367,524
Anila Guri	lekë										304,622				
Anila Guri	lekë												2,000,000	2,206,580	
Anila Guri	lekë													342,040	
D.G	lekë			117,599	99							108,823			
TOTAL LEKE	LEKE	0	628,964	1,002,714	978,812	862,000	2,131,359	3,126,982	2,927,992	3,743,959	4,456,551	6,262,960	6,529,319	8,432,249	9,319,976

Në prapësimet ndaj rezultatit të hetimit, subjekti ka dhënë sqarime mbi gjendjen e të ardhurave dhe të kursimeve, duke parashtruar konkluzionin për secilin vit, i cili në analizën e Komisionit ka rezultuar me bilanc negativ (2006, 2007, 2009, 2011, 2012 dhe 2015), konkretisht:

Lidhur me vitin 2006:

“Për sa më sipër, vlerësoj se: nëse do të zbriten shpenzimet e mia për periudhën prej tre muajsh që nuk kam jetuar në banesën time, në shpenzime do të përfshihen vetëm shpenzimet e udhëtimit për në SHBA. Vlerësoj se kam pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzime, edhe për diferencën e pretenduar nga ana juaj në masën prej 397. 671 lekë.

Mbetet e paqartë për mua se si është llogaritur zvogëlimi i pasurisë në masën 23.902 lekë dhe ku ka gjetur pasqyrim në tabelën e të dhënave.

Gjithashtu, dua të sqaroj se viti 2006 nuk ka filluar me 0 lekë, pasi ka qenë në traditën e shoqërisë dhe të familjeve shqiptare që diçka nga kursimet të mbahej në gjendje cash, pasi vlerësohej se për çdo nevojë kjo ishte mënyra më e sigurt për të siguruar të hollat. Referuar ligjit të kohës kam vlerësuar se deklarimi mbi gjendjen e tyre nuk përbënte pengesë ligjore”.

Lidhur me vitin 2007⁵³:

“Për sa më sipër vlerësoj se, nëse do përfshihen të ardhurat që bashkëshorti ka pasur nga puna për periudhën: nga data 26.9.2007 deri në datën 31.12.2007, rreth 200.000 lekë⁵⁴, do të zbriten shpenzimet për jetesë vjetore në masën 546 480 lekë⁵⁵. Në llogaritjen e shpenzimeve për udhëtime do të merren parasysh konstatimet e mësipërme; vlerësoj se kam pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet edhe për diferencën e pretenduar nga ana juaj në masën prej 356. 066 lekësh”.

Lidhur me vitin 2009:

“Për sa më sipër vlerësoj se: nëse do përfshihen të ardhurat që bashkëshorti ka pasur nga puna, rreth 230. 000 lekë, në llogaritjen e shtim/pakësimeve në depozitat bankare do të merren parasysh pretendimet dhe provat e mia; vlerësoj se kam pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet edhe për diferencën e pretenduar nga ana juaj në masën prej 794.312 lekësh”.

Lidhur me vitin 2011:

“Për sa më sipër vlerësoj se: nëse do përfshihen në të ardhurat edhe shuma e interesave bankare prej 13.000 lekësh, në llogaritjen e shpenzimeve për udhëtime do të merren parasysh konstatimet e mësipërme⁵⁶; në llogaritje do të përfshihen dhe të ardhurat e kursyera, të mbajtura jashtë sistemit

⁵³ Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar dhe as ka deklaruar të ardhura nga bashkëshorti në vitin 2007. Nga ana tjetër, subjekti ka parashtruar se “të ardhurat s’mund të jenë zero..” por pa thënë se sa të ardhura realizoi konkretisht.

⁵⁴ Meqenëse në vitin 2007 ka të dhëna vetëm për qarkullimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka të dhëna lidhur me fitimin e realizuar nga momenti i regjistrimit si avokat në shtator të vitit 2007 e deri në fund të vitit. Komisioni, lidhur me këtë pretendim të subjektit për të ardhurat e periudhës tetor – dhjetor 2007, çmoi të marrë në konsideratë fitimin e vitit 2008, si referencë për të llogaritur të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si avokat për periudhën tetor – dhjetor 2007, në vlerën 225.450 lekë = fitimi neto sipas tatimeve i vitit 2008, në shumën 901.800 lekë/12 * 3 muaj. Shuma 225.450 lekë është shtuar si e ardhur e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitin 2007.

⁵⁵ Shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë llogaritur si mesatare e ponderuar e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007 (shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë 943.872) dhe vitin 2008 (shpenzimet e jetesës për vitin 2008 janë 546.480 lekë) dhe janë marrë 745.176 lekë/vit shpenzimet e jetesës për vitin 2007, dhe jo sa i ka vënë ILDKPKI-ja.

⁵⁶ Komisioni i analizon shpenzimet gjatë udhëtimit dhe periudhës së qëndrimit jashtë, duke përllogaritur normën 10 euro/ditë.

bankar, të fituara gjatë vitit 2010; vlerësoj se kam pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet edhe për diferencën e pretenduar nga ana juaj në masën prej 322.080 lekësh”.

Lidhur me vitin 2012:

“Për sa më sipër vlerësoj se: në llogaritjen e shpenzimeve për udhëtime do të merren parasysh pretendimet dhe konstatimet e mësipërme; në llogaritje do të përfshihen edhe të ardhurat e kursyera, të mbajtura jashtë sistemit bankar, të fituara gjatë vitit 2010, vlerësoj se kam pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar shpenzime, edhe për diferencën e pretenduar nga ana juaj në masën prej 463.433 lekësh”.

Lidhur me vitin 2015:

“Për sa më sipër vlerësoj se: nëse do të rivlerësohet situata lidhur me sasinë e kursimeve të pretenduara se janë krijuar rishtazi në vitin 2015, në shpenzimet e udhëtimit do të merren në konsideratë pretendimet dhe provat e mia lidhur me udhëtimin e fëmijës K.G.; vlerësoj se nuk do të kemi një gjendje debitore midis të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2015”.

Për sa më sipër, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar dhe as ka deklaruar të ardhura nga bashkëshorti në vitin 2007. Nga ana tjetër, vetë subjekti ka parashtruar se “të ardhurat s’mund të jenë zero”, por pa thënë se sa të ardhura realizoi konkretisht.

Meqenëse në vitin 2007 ka të dhëna vetëm për qarkullimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka të dhëna lidhur me fitimin e realizuar nga momenti i regjistrimit si avokat në shtator të vitit 2007, deri në fund të vitit dhe lidhur me këtë pretendim të subjektit për të ardhurat e periudhës tetor – dhjetor 2007, Komisioni çmoi të marrë në konsideratë fitimin e vitit 2008, si reference për të llogaritur të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si avokat për periudhën tetor – dhjetor 2007 në shumën 225.450 lekë = fitimi neto, sipas tatimeve të vitit 2008, në shumën 901.800 lekë/12 * 3 muaj. Shuma prej 225.450 lekësh është shtuar si e ardhur e bashkëshortit të subjektit për vitin 2007.

Në vijim, me kërkesën nr. (***) prot., datë 16.7.2019, subjekti i rivlerësimit kërkoi depozitimin e dy kartelave të klientit, të lëshuara nga Banka e Shqipërisë, konkretisht: (1) kartela e klientit nr. (***), për periudhën: 1.4.2006 – 29.1.2015; dhe (2) kartela e klientit nr. (***), për periudhën 1.1.2006 – 15.1.2015, që të dyja në emër të subjektit.

Dy kartelat e klientit nga Banka e Shqipërisë, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, u bënë pjesë e fashikullit të akteve (ato nuk ishin pjesë e materialeve shoqëruese të përgjigjes së Bankës së Shqipërisë⁵⁷) dhe u administruan si prova shkresore dhe, për këtë shkak, Komisioni rishikoi analizën financiare që i kishte komunikuar subjektit të rivlerësimit, duke arritur në rezultatin përfundimtar që pasqyrohet në dy tabelat e mëposhtme.

Lidhur me këto udhëtime që subjekti i rivlerësimit pretendoi se bashkëshorti i saj ka qëndruar tek i vëllai, që banon në Forli, ka vënë në dispozicion të Komisionit një kontratë qiraje që vërteton se vëllai i tij jeton në Forli. Për 3 udhëtime të bashkëshortit të subjektit në vitin 2011 me destinacion Forlin, trupi gjykues çmoi që për shpenzimet e qëndrimit gjatë këtyre udhëtimeve në këtë destinacion të llogariten me 10 euro/ditë.

⁵⁷ Banka e Shqipërisë – kthim përgjigjeje nr. (***)prot., datë 30.1.2019 – bashkëlidhur kësaj shkrese janë: informacion mbi gjendjen e klientit L. Q. K., periudha 9.9.2014 – 11.9.2014; informacion mbi gjendjen e klientit Anila P. Guri, periudha 11.12.2012 – 11.12.2014; përmbledhje e transaksioneve të klientit L. K. .

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Pasuri	-23,902	-116,813	1,269,359	1,895,624	301,009	815,967	712,593	1,806,409	1,306,358	862,931	1,834,617
Tokë truall 1000 m ² Rr."****" Tiranë											
Banesë 2 kate + papafingo											
Autoveturë Benz me targë ***											
Banesë e ndodhur në plazh ***, Velipojë											
Automjet "Land Rover"				900,000							
Automjet Golf Volkswagen i blerë në vitin 2010					500,000						
Automjet tip Mercedes Benz											946,890
Shtesa/pakësime likuiditete CASH dhe bankë	-23,902	-116,813	1,269,359	995,624	-198,991	815,967	712,593	1,806,409	1,306,358	862,931	887,727
Total likuiditete	978,812	862,000	2,131,359	3,126,982	2,927,992	3,743,959	4,456,551	6,262,960	7,569,319	8,432,249	9,319,976
Detyrime	0	0	0	0	0	0	0	570,000	0	0	-570,000
Hua e marrë shtetasit L.T me datë 03.05.2013								280,000			-280,000
Hua e marrë shtetasit L.T me datë 07.08.2013								290,000			-290,000
Pasuri neto	-23,902	-116,813	1,269,359	1,895,624	301,009	815,967	712,593	1,236,409	1,306,358	862,931	2,404,617
Të ardhurat	386,527	1,077,309	2,478,367	2,108,683	2,331,761	1,510,587	1,165,350	2,330,413	2,900,440	1,976,889	4,757,136
Të ardhura nga punësi mi subjekti	374,995	840,088	830,484	988,084	1,036,524	1,015,827	1,010,145	1,086,029	1,315,258	1,348,847	1,358,609
Të ardhura nga punësi mi bashkëshorti	0	225,450	901,800	441,000	1,152,000	421,232	-32,823	599,750	1,556,108	585,608	1,678,732
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave	11,532	11,771	23,002	129,599	143,237	73,528	78,028	74,634	29,074	42,434	
Të ardhura nga shitja e automjetit Benz				550,000							
Të ardhura nga shitja e automjetit Land Rover											1,149,795
Të ardhura të dhuruara nga nëna e subjektit L.K								110,000	70,000		
Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor për D.G			723,081								
Të ardhura të dhuruara bashkëshortit nga L.T								500,000			
E ardhur nga L.T (falur huaja 280.000 dhe 290.000)											570,000
Shpenzime	844,697	999,087	812,554	1,007,371	581,183	928,188	916,190	1,009,964	1,678,619	1,235,723	1,826,387
Shpenzime shkollimi për fëmijët											445,038
Shpenzime jetese	401,761	745,176	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	442,936	253,911	266,074	460,891	34,703	381,708	352,094	445,868	798,627	338,619	440,980
Të ardhura - Pasuri - Shpenzime	-434,268	195,035	396,454	-794,312	1,449,569	-233,568	-463,433	84,040	-84,538	-121,764	526,133
											Totali i shumës së pambuluar me burime të ligjshme -2,131,883

Likuiditete në Bankë sipas viteve		2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Kursi i këmbimit	euro usd	133.65 108.69	126.74 94.58	122.54 103.33	123.70 93.67	120.91 83.03	123.18 90.96	137.17 93.98	138.81 104.95	138.30 105.08	139.72 106.57	140.21 102.38	140.11 113.64	137.65 126.64	135.27 128.29
Raiffeisen Bank		0	628,964	890,925	780,846	828,320	2,088,244	3,088,074	993,845	959,729	1,174,976	1,329,516	2,007,985	2,747,721	2,946,515
Anila Guri	lekë			107,492	-26,802	54,498	159,233	47,820							
Anila Guri	lekë						800,000	1,000,000							
Anila Guri	lekë							442,250							
Anila Guri	euro		2,500	3,007	3,500	3,547	5,116	4,350							
Anila Guri	usd		3,300	4,016	4,000	4,154	5,154	9,995	7,640	8,760	10,978	12,978	16,183	21,217	21,217
Anila Guri	usd								84						
D.G	lekë						30,001	6,627	5,427	39,228	5,028	829	9,932	9,933	33,786
D.G	euro												1,132	366	1,407
K.G	lekë							20,116	62,548				440	440	440
K.G	lekë							35,243	115,243						
Bankës Intesa Sanpaolo Albania sha		0	0	0	205,235	42,843	43,115	38,908	36,523	-3,888	0	0	0	0	0
Anila Guri	usd				0										
D.G	usd				2,191	516	474	414	348	-37					
Bankës së Shqipërisë		0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,040,000	1,040,000	1,040,000	0	0
Anila Guri	lekë										1,040,000	1,040,000	1,040,000		
Bankës Procredit sha		0	0	-5,810	-7,368	-9,164	0	0	0	0	0	0	0	0	0
D.G	lekë			-5,810	-7,368	-9,164	0								
Bankës Kombëtare Tregtare sh.a		0	0	0	0	0	0	0	1,897,539	2,678,804	2,229,883	3,186,010	3,892,919	3,667,439	3,457,317
Anila Guri	lekë								500,000	815,903		866,156	878,818	497,493	0
Anila Guri	euro								10,068	13,470	15,597	15,997	20,706	22,959	24,990
D.G	euro										143	131	120	8	0
D.G	lekë										30,690	58,547	96,170	8,538	76,920
Bankës Credins sha		0	0	117,599	99	0	0	0	85	109,314	11,692	707,434	628,415	2,017,090	2,916,144
Anila Guri	lekë								85	109,314	11,692	293,989	628,415	17,090	367,524
Anila Guri	lekë										304,622				
Anila Guri	lekë													2,000,000	2,206,580
D.G	lekë			117,599	99						108,823				342,040
TOTAL LEKE	LEKE	0	628,964	1,002,714	978,812	862,000	2,131,359	3,126,982	2,927,992	3,743,959	4,456,551	6,262,960	7,569,319	8,432,249	9,319,976

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon:

- Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga bankat.
- Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme, për të justifikuar shtesën në kursimet gjatë periudhës 2006 – 2016, për vitet 2006, 2009, 2011, 2012, 2014 dhe 2015 (siç përshkruhet në tabelat e mësipërme), duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën 2.131.883 lekë.

Gjetje nga Komisioni gjatë hetimit administrativ

- Shtetasi L. T. është ortak në disa shoqëri tregtare që ushtrojnë aktivitete të ndryshme: “A.” sh.p.k., ((***)), “(***)” 2010 sh.p.k., ((***) dhe “(***)” sh.p.k. ((***)). Në datën 3.5.2013, në bazë të një kontrate huaje z. L. T. jep hua personit të lidhur, D. G., shumën 280.000 lekë, me afat deri në datën 30.4.2014, pa kamatë dhe pa interesa. Po kështu, në datën 7.8.2013, mes të njëjtave palë, është nënshkruar një tjetër kontratë huaje për shumën 290.000 lekë, në të njëjtat kushte si ajo e datës 3.5.2013 (edhe paraqitja është e njëjtë). Në bazë të një deklarate me shkrim të muajit mars 2016, shtetasi L. T., deklaron me shkresë të thjeshtë se e ka falur huan që i kishte dhënë personit të lidhur, D. G., në datat 3.5.2013 dhe 7.8.2013, në shumën totale 570.000 lekë.
- Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimin sipas të dyja kontratave, por nuk ka dhënë asnjë specifikim mbi qëllimin e detyrimit financiar.
- Gjithashtu, në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ky shtetas ka bërë një dhurim në vlerën 500.000 lekë, që i derdh në llogarinë bankare të personit të lidhur, D. G., në “Credins Bank”, në datën 11.3.2013.
- **Për sa më sipër, bazuar në pikën 14, të nenit 3 dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi L. T., plotëson kriteret ligjore për t’u kualifikuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit.**
- Sipas informacionit të administruar gjatë hetimit administrativ nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, shtetasi L. T., rezulton se ka qenë i siguruar për llogari të subjekteve “(***)” sh.p.k., “(***)” dhe “(***)”, për periudhën janar – dhjetor 2012, me një pagë bruto prej 50.000 lekësh/muaj, në secilën prej këtyre shoqërive.
- E pyetur mbi këto fakte, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

“Shuma prej 280.000 lekësh është marrë në datën 3.5.2013, pasi bashkëshorti, duke konstatuar se vuante nga një sëmundje, vlerësoi të bënte një kontroll mjekësor jashtë vendit, por në fakt nuk e bëri.

Shuma 290.000 lekë, marrë në datën 7.8.2013, u mor për të paguar një tarifë fillestare me qëllim për të marrë pjesë në një procedurë përmbartimore, nga e cila u hoq dorë.

...unë nuk kam pasur dhe nuk kam asnjë lloj marrëdhënieje me shtetasin L. T. .

...dhuruesi kishte dëshirë t’ia dhuronte bashkëshortit tim këto shuma dhe mundësitë e tij ekonomike ia lejonin këtë gjë.”

- Komisioni, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit dhe personit tjetër të lidhur, kreu një vlerësim të mundësive financiare për të përcaktuar nëse kanë pasur ose jo gjendje të mjaftueshme të ardhurash dhe kursimesh për krijimin e kësaj shume dhe, nëse personi tjetër i lidhur kishte apo jo burime të ligjshme, të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

- Nga informacioni i administruar gjatë hetimit administrativ për shtetasin L. T. nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore⁵⁸ rezulton: për periudhën janar 2012 – maj 2013 (duke konsideruar se huaja e parë është dhënë në fillim të muajit maj 2013) ai ka pasur të ardhura neto si më poshtë:

Viti	Të ardhurat ⁵⁹	Shpenzime jetese	Të ardhura neto ⁶⁰
2012	1.131.541	141.024	990.517
2013	305.392	47.008	258.384
Total	1.436.933	188.032	1.248.901

- Në vitin 2013 z. L. T. i ka dhënë hua shumën 570.000 lekë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe i ka dhuruar shumën prej 500.000 lekë, ndërkohë që të ardhurat neto të këtij shtetasi kanë qenë në shumën 1.248.901 lekë.
- Duket se z. L. T., nga informacioni i administruar gjatë hetimit, ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar shumat e mësipërme të dhëna hua apo të dhuruara bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
- Për vitin 2013 janë marrë në konsideratë: dhurata e përfituar nga bashkëshorti i subjektit, si dhe huat e marra në vitin 2013, nga shtetasi L. T. . Të dhënat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Viti	2013
Pasuri	1.806.409
Shtesa/pakësime likuiditete <i>cash</i> dhe bankë	1.806.409
Detyrime	570.000
Hua e marrë shtetasit L. T., datë 3.5.2013 ⁶¹	280.000
Hua e marrë shtetasit L. T., datë 7.8.2013 ⁶²	290.000
Pasuri neto	1.236.409
Të ardhurat	2.330.413
Të ardhura nga punësimi i subjektit	1.086.029
Të ardhura nga punësimi i bashkëshortit	599.750
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave	74.634
Të ardhura të dhuruara nga nëna e subjektit, znj. L. K.	70.000
Të ardhura të dhuruara bashkëshortit nga z. L. T.	500.000
Shpenzime	1.009.964
Shpenzime jetese	564.096
Shpenzime udhëtimi	445.868

⁵⁸ Shihni përgjigjen nr. (***) prot., datë 7.5.2019, të ISSH-së.

⁵⁹ Sipas ISSH-së, të ardhurat pasi janë zbritur tatimet dhe sigurimet shoqërore.

⁶⁰ Të ardhurat neto janë diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve të jetesës.

⁶¹ Shihni kontratën e huas, datë 3.5.2013.

⁶² Shihni kontratën e huas, datë 7.8.2013.

- Në lidhje me sa më sipër, në prapësimet ndaj rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar:

“Shuma 280.000 lekë, e marrë në datën 3.5.2013, ka qenë vullneti dhe dëshira e bashkëshortit që mendoj t’i përdorte për një kontroll mjekësor jashtë vendit, dhe duke qenë se me shtetasin z. L. T. kishte vendosur një marrëdhënie shoqërore, ky i fundit, tregoi gatishmërinë dhe mundësitë ekonomike ia lejonin, i mori borxh këtë shumë, duke vlerësuar të mos më kërkonte të prekja depozitat në të holla, që ishin vendosur në emrin tim në banka të nivelit të dytë. Bashkëshorti im kishte qenë për vizitë në Forli, Itali tek i vëllai, në fillim të muajit prill dhe kishte biseduar me këtë të fundit për t’i planifikuar një vizitë mjekësore. Shuma 290.000 lekë, e marrë në datën 7.8.2013, u mor për të paguar një tarifë fillestare me qëllim për të marrë pjesë në një procedurë përmbartimore, por që më pas nga bashkëshorti im u pa pa interes dhe u hoq dorë. Këto shuma ishin marrë pa afat dhe pa interesa dhe huadhënësi nuk kishte treguar asnjë interes për kërkimin e tyre, fakt që konfirmohet edhe nga fakti që më vonë na i falë”.

Nga sa më sipër:

- Rezulton se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga “Credins Bank”.
- Ka rezultuar se marrja dhe pranimi i dhuratës prej 500.000 lekësh nga shtetasi L. T., si dhe i dy huave të marra në shumën totale prej 570.000 lekësh nga ky shtetas në vitin 2013, nuk janë përdorur për blerje pasurie, por janë shuma të depozituara në sistemin bankar, për të cilat janë përfituar interesa nga bashkëshorti i subjektit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi shkaqet që kanë sjellë këtë situatë.
- Nga analiza financiare e vitit 2013 rezulton: subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera gjatë vitit 2013, si dhe për të justifikuar shtesën në kursimet e këtij viti, për sa kohë burimi i të ardhurave të huadhënësit është provuar.

Gjetje nga Komisioni gjatë hetimit administrativ

- Shtetasit: E. H. dhe A. H. (bashkëshortë), sipas deklarimit në deklaratën periodike të vitit 2017, i kanë dhënë hua personit të lidhur, D. G., shumën 20.000 euro, pa interesa, për të cilat deklarohet se i janë kaluar në llogarinë e BKT-së në bazë të kontratës datë 3.4.2017.
- Në lidhje me këtë hua, nuk specifikohet në deklaram qëllimi i detyrimit financiar. Mbi marrëdhënien me këta shtetas, subjekti ka dhënë sqarime gjatë hetimit administrativ, nga ku ka rezultuar se huaja është përdorur për blerjen e një apartamenti në Tiranë, në Rr. “(***), me sip. 68.7 m² dhe çmim 64.000 USD.
- Për sa më sipër, bazuar në pikën 14, të nenit 3, dhe në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasit E. H. dhe A. H. plotësojnë kriteret ligjore për t’u kualifikuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit.
- E pyetur mbi këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

“Për blerjen e këtij apartamenti janë përdorur të hollat e kursyera në vite nga puna ime dhe e bashkëshortit tim, të ndodhura pranë ‘Raiffeisen Bank’ sh.a., e cila ka qenë 21.217 USD, të ndodhura dhe pranë ‘Bankës Kombëtare Tregtare’ sh.a., në vlerën prej 25.000 euro. Pjesa tjetër e vlerës së banesës është siguruar nga huaja e marrë nga bashkëshortët E. dhe A. H.”.

- Gjendja e shumës 21.217 USD në “Raiffeisen Bank” dhe e shumës 25.000 euro në “Bankën Kombëtare Tregtare”, si dhe tërheqja e tyre në datat 3.4.2017 – 5.4.2017, konfirmohen nga përgjigjet përkatëse të këtyre bankave dhe materialeve bashkëngjitur⁶³.
- Kalimi i shumës së huas nga huadhënësit E. dhe P. H. konfirmohet nga përgjigjja dhe materialet shoqëruese bashkëngjitur të BKT-së, nga të cilat rezulton se në datën 3.4.2017 është kryer transferta e shumës 20.000 euro në llogarinë bankare në këtë bankë, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur⁶⁴.
- Transaksioni mbi apartamentin e mësipërm konfirmohet nga përgjigjja dhe materialet shoqëruese bashkëngjitur të ZVRPP-së, Tiranë⁶⁵, nga të cilat rezulton se: subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes nr. (***) datë 3.4.2017, për blerjen e apartamentit të regjistruar si pasuria nr. (***) z. k., (***) vol. (***) f. (***) Tiranë, kundrejt çmimit 64.000 USD, e konvertuar në shumën 5.200.000 lekë, shumë e cila do të depozitohet në llogarinë e noteres në “Bankën Kombëtare Tregtare”.
- Komisioni, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, hetoi duke kërkuar informacion nga “Credins Bank”, e cila konfirmoi faktin se bashkëshortët E. dhe P. H. janë aksionerë të kësaj banke dhe, nga gjendja e likuiditeteve që zotërojnë në këtë bankë, kanë kryer edhe transfertën e shumës së huas prej 20.000 euro⁶⁶.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludon se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratën vjetore të pasurisë dhe interesave të vitit 2017 dhe nuk kanë rezultuar mangësi në burimet financiare.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. (***) prot., datë 29.1.2019, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. (***) datë 24.1.2019, të KDZH-së (bazuar në kërkesën e Komisionit me shkresën nr. (***) prot., datë 22.1.2018).

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka të njëjtat të dhëna si ato të deklaruara në formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

⁶³“Raiffeisen Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr(***)prot., datë 1.2.2019, si dhe materialet bashkëngjitur.

“Banka Kombëtare Tregtare” ka thyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2019, si dhe materialet bashkëngjitur.

⁶⁴ Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2019, si dhe materialet bashkëngjitur të BKT-së.

⁶⁵ ZVRPP-ja Tiranë, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 13.2.2019, si dhe materialet bashkëngjitur.

⁶⁶ “Credins Bank” ka kthyer përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 27.5.2019, si dhe materialet bashkëngjitur.

Gjithashtu, pas verifikimit nga Komisioni, nuk janë gjetur *indicie* për kontakte të papërshtatshme, që të ndikojnë në përshtatshmërinë ose jo për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

1. Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLGj-së, sipas shkresës nr. (***) prot., datë 11.4.2019, “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Anila Guri”, të cilin e ka dërguar në Komision si pjesë e praktikës me nr. (***) prot., datë 8.2.2019.
2. Vlerësimit të denoncimeve dhe vendimet gjyqësore të paraqitura në ankesat e subjekteve denoncuese.
3. Kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Raporti për analizën e aftësive profesionale i kryer nga KLGj-ja është bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti;
- pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

Nga analiza e KLGj-së, mbi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, është nënshkruar në çdo fletë dhe është i rregullt nga pikëpamja formale. Subjekti nuk ka deklaruar adresë zyrtare.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas formularit të vetëdeklarimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), nga janari i vitit 2007 e në vazhdim ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Tri vitet e fundit, subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), sipas formularit të vetëvlerësimit, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo gjykatë është e organizuar në seksione dhe znj. Anila Kristani ka punuar në seksionin civil, duke gjykuar mosmarrëveshje civile të paraqitura pranë gjykatës në tri vitet e fundit.

Subjekti, në lidhje me fushën e të drejtës që lidhet me specializimet, ka deklaruar se nuk ka të tilla. Megjithatë, nga dokumentacioni që shoqëron formularin e vetëvlerësimit rezulton se sipas vërtetimit datë 17.10.2016, të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, znj. Anila Guri (Kristani) është regjistruar në departamentin e të Drejtës Civile të Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës dhe vazhdon programin e studimeve të Doktoraturës që prej datës 22.7.2011.

Lidhur me ngarkesën sasiore, subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), ka deklaruar se tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar për shqyrtim gjithsej 1582 çështje, dhe ka

përfunduar me vendim përfundimtar 1268 çështje civile dhe 291 çështje penale. Subjekti Anila Guri ka mbartur për vitin e fundit të ushtrimit të detyrës, gjithsej 135 çështje.

d) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Sipas vërtetimit nr. (***) prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja Anila Guri (Kristani), ka qenë pjesëmarrëse në 17 aktivitete trajnuese të organizuara nga shkolla.

e) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, të llojit “vendim gjyqësor”. Një prej këtyre vendimeve ka qenë i vitit 2013 (jashtë periudhës së vlerësimit), një i vitit 2015 dhe një i vitit 2016.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGj-së

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Anila Kristani, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë vijon:

1. Aftësitë profesionale

a) *Njohuritë ligjore*

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore, të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se subjekti i rivlerësimit, gjyqtare Anila Guri (Kristani), ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Subjekti Anila Guri identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Anila Guri (Kristani) kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor (shihni dokumentet 2, 3 dhe dosjet 1, 2 e 3). Identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertët e fushës (shihni dosjet 1 dhe 2). Subjekti zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi, dhe vendimi i dhënë prej saj lihet në fuqi nga gjykatat më të larta, ose nuk ankimohet nga palët (shihni dosjet 1, 2 dhe 3). Njeh dhe zbaton ligjin për “falimentimin”, (shihni dokumentin 1). Njeh dhe zbaton institutin e parashkrimit në veprimet juridiko-civile (shihni dokumentin 2), kur është rasti, përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre (shihni dosjen 3). Në një rast, gjyqtarja ka përdorur edhe referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, në zbatimin e dispozitave të Kodit Civil për cilësimin e marrëdhënies juridike, pavarësisht formulimit të palëve (shihni dosjen 1). Megjithatë, në drejtim të zbatimit të ligjit konstatohen mangësi në dosjen nr. 5, në shqyrtimin e kërkesave me objekt vlerësimi “arrest në flagrancë” dhe caktim mase sigurimi “arrest në burg”. Rezultoi se gjyqtarja ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” ndaj personit nën hetim, pa iu referuar dhe pa zbatuar kriteret e veçanta që parashikon neni 230 i Kodit të Procedurës Penale për caktimin e kësaj lloji mase sigurimi me karakter shtrëngues. “Arrestin në burg” përfaqëson masën ekstreme të sigurimit personal, përbën

privim të lirisë së personit, prandaj dhe gjyqtari duhet të argumentojë arsyet e dhënies së kësaj mase, duke sqaruar përse masat e tjera më të buta janë të papranueshme në rastin konkret.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore, përfundimtare, të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja, si dhe në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. E vetmja mangësi që u konstatua në arsyetimin e vendimit ishte në rastin e dosjes nr. 5 (më lart janë sqaruar mangësitë e konstatuara në arsyetimin e vendimit që i përket asaj dosjeje).

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim gjithsej 1582 çështje, ku ka përfunduar 1268 çështje civile dhe 291 çështje penale, duke mbartur vitin e fundit 135 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 98.6 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Anila Guri (Kristani) ka përfunduar 1529 çështje, nga të cilat 702 çështje civile themeli, 565 çështje civile të përgjithshme (kërkesa civile), 257 çështje penale (masa sigurimi) dhe 5 kërkesa penale.

Sipas germës “e”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë, që nuk është i organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile me palë kundërshtare. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 360 gjykime çështjesh të tilla për tri vjet. Sipas tabelave të përpiluara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit rezulton se gjyqtarja Anila Guri (Kristani) në vitet 2014 - 2016 ka gjykuar 702 çështje civile me palë kundërshtare. Rrjedhimisht, ajo ka pasur ngarkesë sasiore pothuajse dyfishin e standardit sasior të paracaktuar.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Anila Guri (Kristani) i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në katër raste afatet ligjore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për tri ditë nga shpallja (shihni dosjen 1), për nëntë ditë nga shpallja (shihni dosjen 1), për tetë ditë nga shpallja (shihni dosjen 2), për 14 ditë nga shpallja (shihni dosjen 3) dhe për gjashtë ditë nga shpallja (shihni dosjen 4). Pra, vetëm në një rast është tejkaluar me katër ditë afati ligjor për arsyetimin e vendimit (shihni dosjen 3).

Gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, për gjyqtaren Anila Guri (Kristani) janë paraqitur gjithsej pesë ankesa në ish-Inspektoratin e KLD-së, ku tri prej tyre janë arkivuar pas

shqyrtimit fillestar dhe dy të tjera që i përkasin vitit 2014, ku pretendohej zvarritje gjykimi, pas verifikimit të tyre i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi etik dhe profesional (shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së). Rrjedhimisht, për veprimtarinë e saj gjyqësore, në drejtim të respektimit të afateve standarde të gjyqimit janë konstatuar të dhëna negative nga shqyrtimi i dy ankesave, të dhëna të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për t'u klasifikuar si shkelje disipline, por kanë shërbyer si mangësi në vlerësimin e saj profesional.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), nuk është efiçiente dhe efektive në çdo çështje që ka shqyrtuar. Respektimi i kohës në gjykim përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor. Në efiçektivitetin dhe efiçiencën e veprimtarisë së saj mund të ketë ndikuar edhe ngarkesa sasiore e lartë në gjykim. Në shumicën e rasteve, gjykimet kanë përfunduar përtej afateve të arsyeshme. Ndryshe nga afati i gjyqimit, gjyqtarja i ka kushtuar më tepër rëndësi kohës së arsytimit të vendimeve gjyqësore, ku në shumicën e rasteve afatet ishin respektuar.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), ka shfaqur aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në dy raste (dosjet 2 dhe 5), por ka shfaqur mangësi për të kryer si duhet procedurat gjyqësore në tri raste (dosjet 1, 3 dhe 4). Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore (dosjet 1 dhe 5). Në katër çështje civile themeli të vëzhguara, gjyqtarja ka kryer rregullisht veprimet përgatitore, por konstatohet se në tri raste veprimet përgatitore janë zhvilluar në mënyrë formale, duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur përgatitjes së çështjes për gjykim (dosjet 1, 3 dhe 4). Veprimet përgatitore janë dokumentuar rregullisht me procesverbal.

Në pesë çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 21 seanca (shihni dosjen 1), me 10 seanca (shihni dosjen 2), me 13 seanca (shihni dosjen 3), me 6 seanca (shihni dosjen 4) dhe me 1 seancë (shihni dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 51 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 23 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 29 seanca gjyqësore joproductive janë bërë organizimi i punës nga gjyqtarja, mungesat e palëve, kërkesat e palëve për të sjellë prova të tjera, mungesat e avokatëve të palëve, e ekspertëve, mungesat e gjyqtarës për shkaqe shëndetësore etj.

Seancat e vëzhguara, përgjithësisht, janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por vihen re edhe raste kur nuk shënohet në procesverbal ora e fillimit apo e mbylljes së seancës përgatitore. Seancat, rrallë janë regjistruar në audio dhe në procesverbalin gjyqësor nuk jepet ndonjë shpjegim se përse nuk janë zhvilluar proceset gjyqësore me regjistrim audio.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtarja, është mbajtur procesverbal administrativ nga sekretarja gjyqësore për të pasqyruar këtë fakt dhe për të njoftuar palët për seancën vijuese. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si: kërkesëpadi apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Anila Guri (Kristani) ka marrë titullin “jurist” në Universitetin e Tiranës, në datën 27.6.1993. Pas studimeve, në datën 30.8.1996, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Anila Guri (Kristani) (shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së). Gjithashtu, edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani). Për vetë gjyqtaren Anila Guri (Kristani) në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në të tria dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Guri (Kristani), nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, ka qenë i qartë për sa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse, si dhe pyetjeve të bëra nga gjykata. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Anila Guri për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, madje edhe kur anëtarë të trupit gjykues kanë qenë të caktuar me delegim nga një gjykatë tjetër (shihni dosjen 4). Vonesat në fillimin e seancave gjyqësore kanë qenë të pakta në numër (3 seanca gjithsej) dhe deri në 17 minuta vonesë, që nuk ka penguar ecurinë

e seancës. Këto të dhëna tregojnë për një bashkëveprim normal me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit është angazhuar thellësisht në aktivitete profesionale, duke i kushtuar rëndësi formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, në të cilën ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 17 seminare të organizuara prej saj.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në denoncimet e shtetasve si më poshtë:

Komisioni administroi dhe mori në shqyrtim 11 denoncime nga publiku. Denoncimet hidhnin dyshime mbi: procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë procesit gjyqësor (proces të parregullt ligjor; hetim të njëanshëm në shkelje të ligjit material dhe procedural); zvarritjen e procesit, vendimmarrjen, gjykimin e njëanshëm, shkeljen e etikës etj.

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë bërë këto denoncime:

1. denoncim nr. (***) prot., datë 23.1.2018, i shtetases A. V. N.;
2. denoncim nr. (***) prot., datë 7.2.2018, i shtetasit S. M. R.;
3. denoncim nr. (***) prot., datë 13.4.2018, i shtetasit I. Z. K.;
4. denoncim nr. (***) prot., datë 6.6.2018, i shtetasit Sh. R. M.;
5. denoncim nr. (***) prot., datë 13.8.2018, i shtetasit H. Sh. H. etj.;
6. denoncim nr. (***) prot., datë 15.8.2018, i shtetasit A. A. A.;
7. denoncim nr. (***) prot., datë 11.9.2018, i shtetasit A. F. D.;
8. denoncim nr. (***) prot., datë 14.2.2019, i shtetasit H. S. R.;
9. denoncim nr. (***) prot., datë 20.4.2018, i shtetasit S.M. R.;
10. denoncim nr. (***) prot., datë 12.6.2018, i shtetasit R. R. D.;
11. denoncim nr(***) prot., datë 27.6.2018, i shtetasit F. M. D. .

Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, nenit 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 dhe në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të paraqiste shpjegimet e saj në lidhje me: vlerësimin e kriterit profesional të realizuar mbi tri dokumentet e dorëzuara nga vetë subjekti; pesë dosjet e përzgjedhura me short; dhe 11 denoncimet e publikut.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 11.7.2019, ka depozituar në Komision prapësimet e saj në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional.

Në përfundim të shqyrtimit të denoncimeve dhe të materialeve të lidhura me to, të administruara kryesisht nga Komisioni, rezultoi: nuk ka prova për të vërtetuar gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në të shumtën e rasteve, faktet dhe shkaqet, për të cilat bëhen denoncimet, lidhen me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit gjyqësor, të cilat kontrollohen dhe vlerësohen nga gjykata në nivel më të lartë, sipas procedurës dhe këto nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për sa më sipër, Komisioni konkludoi:

Pas shqyrtimit nga Komisioni të raportit të vlerësimit profesional të KLGj-së, si dhe të të gjitha akteve të tjera në lidhje me denoncimet e mësipërme, rezultoi: ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana

të cilat mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, por jo një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë,

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Branko Hrvatini, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Guri, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 19.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim Hamitaj
Kryesues

Alma Faskaj
Relatore

Suela Zhegu
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta